



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i VIII i botimit, nr. 110, Dhjetor 2012
Nr. Llog. BKT 410027968, Shkodër - Albania, Tel. 00355683191817, 0035692328116, internet: www.shoqatadukagjini.org, Kryeredaktor: Lazër Kodra, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

2 - NIKOLLË VOCAJ - KRENARË QË TË PATËM, KEQARDHJE QË U NDAMË PARAKOHE



Pas një sëmundje të rëndë dhe të pamëshirshme, ndahet nga jeta Nikollë Vocaj, ose siç e njohin edhe shumë njerëz Nikollë Tomë Gjonin. Ja mori jetën kjo sëmundje në moshën e pjekurisë më të mirë, në moshën që e deshëm që ta kishim në mesin tonë dhe kjo jo vetëm fizikisht por edhe për mençurinë e tij, urtësinë, tolerancën dhe arsyetimin e tij të thellë, për bashkëpunimin dashamirës të tij me të gjithë. E donin ta kishin përsëri nëna e tij File, bashkëshortja Marije, fëmijët Esmeralda, Kreshniku, Emanilda dhe Arditi, motrat Gjystina dhe Liza, vëllezërit Kola, Gjergj, Ndoci, Tonini e Agimi, nipa e mbesa, të afërmit e tjerë, por gjithë shoqëria kudo ku punoj dhe jetoj Nikolla dhe familja e tij.

POPULLI MË I VJETËR I BALLKANIT PA DYSHIM ËSHTË POPULLI SHQIPTAR, I CILI NË KOHËRAT E VJETRA PREJ ADRIATIKUT DERI NË DANUB, TUE PËRFSHI EDHE UNGARINË PERËNDIMORE

Kur prof Ibrahim Kelmendi ka shpalosur idetë e tij, ndërkohë ka hedhur teza të guximshme për prejardhjen e shqiptarëve, ka qenë viti 1950. Duke shfletuar gazetën: "Flamuri", botohej ne Romë nga emigracioni politik shqiptar, gjejmë një seri shkrimesh të prof I. Kelmendit që kanë gjuhën, mendjen dhe vlerësimin e tij për gjenezën e shqiptarëve, bit më të hershëm në Europë. Nuk janë thjeshtë citime, por një analizë sintezë me fakte e dokumente të reja.



3 - GJERGJ KASTRIOTI NË DAKAJ-SHALË

-558 VJET MË PARË-

Nga Luigj Shyti

Në krahun e djathtë të lumit të Shalës, rreth një orë në këmbë, mbi një shkëmb, duken rrënojat e një kështjelle që quhet Kalaja e Dakajve dhe shpesh thuhet se është mesjetare. Duke u menduar më thellë mund të bindemi se kjo kështjellë, si edhe të tjera, edhe në Dukagjin, duhet të kenë një zanafille shumë më të hershme. Në një reviste të përmuajshme, vite më parë shkruhet "... Qyteti i Dakajve ... pikërisht këtu ilirët dhe më vonë pasardhësit e tyre në mesjetë ngiten mure aq të fortë sa që edhe sot qëndrojnë ...

5 - KOMPOZIMI I VEÇANTE I NJE LIBRI

Nga Lazër Kodra - Referat në promovimin e librit "Përthyerje e dritës së shpirtit" të autorit Tonin Vasa.

Ne, njerëzit ndodhemi çdo ditë përpara dhjetra e qindra zgjedhjeve, të cilat na i afrojnë jeta, koha dhe nevojat. Të zgjedhësh për të bërë atë që di të bësh është zotësi dhe vetëdije, pushtet mbi veten dhe vlerë shoqërore. Ndër të gjitha zgjedhjet, unë e mendoj se të dish me zgjedh fjalën e duhur në kohën e duhur është më e vështira ndër të gjitha.



5 - MBRET APO TRADHËTAR I SHQIPETARVE?

Nga Dedë Toka

Ahmet Zogu ka lindur në Mat, rrjedhe nga një familje feudalesh. U shkollua jashtë shtetit. Mbas mbarimit të luftës së Ballkanit e largimit të Turqisë, Evropa dergoi në Shqipëri Princ Vidin, pasi kishte mungesë kuadri të përgatitur. Nga çrregullimet e mosmarrveshjet e brendshme, ai i largua. Pas tij erdhi Sulejman Delvina, qelimi I të cilit ishte formimi i një qeverie demokratike të pavarur, ku u mblodhen të gjithë studentet e asaj kohe si: Ndokë Gjeloshi, Ahmet Zogu, Sejfulla Vllamasi nga Kolonja Azis Çami nga Çamëria e shumë të tjerë që ndihmuan Sulejman Delvinin për krijimin e qeverisë, detyrë që e mori përsiper A. Zogu nga që ishte edhe vetë feudal dhe po kështu edhe burrin motres nga Kosova feudal, ishte fejuar me vajzën e Shefqet Verlacit, i cili kishte një pjesë të madhe të Shqipërisë së mesme. I nisur nga kjo prejardhje feudalesh u mbështet mbi ta duke tadhëtuar të gjithë shoket e vet dhe ndihmen e tyre formoi qeverinë e vet.

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP

Mundësoi Botimin:
LULASH GJELOSHI



NIKOLLË VOCAJ - KRENARË QË TË PATËM, KEQARDHJE QË U NDAMË PARAKOHE

Pas një sëmundje të rëndë dhe të pamëshirshme, ndahet nga jeta Nikollë Vocaj, ose siç e njohin edhe shumë njerëz Nikollë Tomë Gjoni. Ja mori jetën kjo sëmundje në moshën e pjekurisë më të mirë, në moshën që e deshëm që ta kishim në mesin tonë dhe kjo jo vetëm fizikisht por edhe për mençurinë e tij, urtësinë, tolerancën dhe arsyetimin e tij të thellë, për bashkëpunimin dashamirës të tij me të gjithë. E donin ta kishin përsëri nëna e tij File, bashkëshortja Marije, fëmijët Esmeralda, Kreshniku, Emanilda dhe Arditi, motrat Gjystina dhe Liza, vëllezërit Kola, Gjergj, Ndoci, Tonini e Agimi, nipa e mbesa, të afërmit e tjerë, por gjithë shoqëria kudo ku punoj dhe jetoj Nikolla dhe familja e tij.

Familja Vocaj zbriti nga Plani i Dukagjinit në vitet e para pas çlirimit dhe fillimisht u vendos në Fushë Kuqe. Zbriti për një jetë më të mirë dhe ju përkushtua punës dhe vetëm punës. Kjo familje rrezatoi mirësi me të gjithë kudo.

Nikolla u lind në vitin 1949 në Fushë Kuqe. Ai ishte fëmija i tretë i çiftit Tomë Gjoni dhe File Markja, çifti simbol i jetës bashkëshortore, i përkushtimit ndaj fëmijëve dhe punës, marrëdhënieve bashkëshortore, por edhe marrëdhënieve shoqërore. Nikolla u rrit në këtë familje me emër të nderuar në Dukagjin dhe në Bregun e Matit, në rrethin e Lezhës dhe kudo që punon dhe punojnë e jetojnë të gjithë pjesëtarët e saj.

Nikolla pas mbarimit të shkollës 8 vjeçare dhe të mesme, në vitin 1969 mbaron shkollën e lartë për profesionin e bukur dhe të nderuar të mësuesit, dukë u bërë një edukator i përkushtuar më nxënësit, me të rinjtë dhe shpejt emërohet në detyrën e drejtorit të shkollës në Tale ku qëndroi deri në vitin 1977, vit në të cilin zgjidhet Kryetar i Këshillit të Bashkuar të Bregut të Matit dhe qëndron për 10 vjet. Në vitin 1987 zgjidhet Kryetar i Këshillit të Bashkuar në Balldre dhe e dorëzon me fillimin e proceseve demokratike. Ai nuk dinte të bënte keq. Edhe me ndryshimin e sistemit politik në vendin tonë Nikolla, vazhdoi me të

njëjtën dashamirësi, çiltërsi, bashkëpunim, tolerancë dhe ishte i ftuar, i mirëpritur e i nderuar midis miqsh dhe shokësh gjithnjë.



Nikolla, në vitin 1975 me bashkëshorten e tij Marijen, bijë e Thehit, bijë e një familje mjaftë të fisme, krijojnë familjen. Ata gjithmonë qenë jo vetëm thjeshtë bashkëshort të merituar, por ishin shokë, bashkëpunëtor. Patën katër fëmijë, dy vajza dhe dy djem, të cilët i rritën dhe edukuan me normat më të mira tradicionale e bashkëkohore dhe i drejtuan me mençuri në jetë.

Nikolla ka punuar dhe drejtuar edhe si sekretar i Prefekturës së Lezhës, Drejtor i Ndërmarrjes Pyjore Lezhë dhe së fundi shefi i klubit të futbollit "Besëlidhja" deri në fund të jetës së tij. Ai ka punuar edhe në shumë detyra vullnetare në shërbim të komunitetit si edhe ka qenë aktiv në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të ndryshme brenda komunitetit. Ka qenë Sekretar i Shoqatës "Atdhetare Dukagjini" për degën e Lezhës dhe disa herë mbështetës financiar i veprimtarive të Shoqatës dhe gazetës "Dukagjini".

Nikolla, në të gjitha detyrat është paraqitur me aftësi profesionale, organizator i aftë, i vendosur në realizimin e tyre gjak ftohtë në marrjen e vendimeve, me respekt dhe dashuri njerëzore, i dashur dhe komunikues me njerëzit. Mbi të gjitha ishte njeri në kuptimin e plotë të fjalës.

Nikolla ishte vërtetë bashkëshort

e familjar shumë i mirë, por edhe një burrë i mirë, vëlla i mirë, i afërm i mirë, koleg i mirë, komshi i mirë, për të cilat kishim të gjithë akoma nevojë, për fjalën e qetë të tij, për dashamirësinë e tij të cilat i kujtojmë sot dhe do të na kujtohen shumë gjatë.

Mirësitë e tij rrjedhin nga edhe nga trashëgimia e trugut familjarë duke i paraqitur në çdo rast me kulturën bashkëkohore të njeriut të kohës, të tipareve më të mira të malësorit dukagjinas. Tiparet e larta të Nikollës na bëjnë krenarë që e patëm, por ndjejmë keqardhje shumë të madhe që u ndamë para kohe prej tij, është krenare nëna e tij File mbi 90 vjeç që i qëndronte te koka, është krenare bashkëshortja Marije, janë dhe duhet të jenë krenar fëmijët e tij, janë krenar vëllezërit dhe motrat, janë krenar të afërmit, shokët e miqtë e shumtë të tij, janë krenar bashkëpunëtorët të të gjithë jetës së tij, është krenare Shoqata "Atdhetare Dukagjini" për anëtarin aktiv të saj, janë krenar kushdo që sadopak e njohu Nikollën. Të gjithë kemi se çfarë ti kujtojmë Nikollës tonë të paharruar.

Ndarja nga jeta e Nikollës ka një dhimbje të madhe për të gjithë, por njerëzit e fuqishëm e kalojnë me durim e guxim. Dhimbja është e madhe, por kur shikon një përcjellje madhore, një pjesëmarrje të jashtëzakonshme njerëzish, një pjesëmarrje pothuaj nga të gjitha instancat e shtetit, dhimbja pa tjetër që shpërndahet dhe lehtësohet dhe duhet të lehtësohet.

Fjalët e ëmbla dhe të thella të Kryetarit të Bashkisë së Lezhës Viktor Tusha, apo edhe të kryetarit të shoqatës "Atdhetare Dukagjini" Ndue Sanaj janë një përmbledhje e bukur vlerësuese, të thjeshta, dashamirëse dhe me shumë dhimbje për Nikollën dhe jetën e veprimtarinë e tij, por dhe ngushëllim për familjen dhe afërmit, shokët dhe miqtë.

Nikolla do të na mungojë shumë, shumë gjatë të gjithëve dhe më shumë familjes dhe të afërmeve të tij. Kjo dihet, por kemi besim se do të gjejnë forca për ta përballuar këtë humbje. Të gjithë kemi

FJALA MORTORE E KRYETARIT TË BASHKISË LEZHË, VIKTOR TUSHA

Të nderuar pjesëmarrës, shokë, miq, të afërm të familjes së Nikollë Vocajt!

Të nderuar bashkëqytetar!

Jemi mbledhur këtu, me lot në sy e dhimbje të thelle në zemër, për t'i dhënë lamtumirën e fundit shokut dhe mikut tone, Nikollë Vocaj.

Kemi ardhur ngadalë, duke përcjellë ketë kortezh të gjatë dhe kemi thënë në heshtje se, u shua dhe një shok, na iku një mik, është larguar nga kjo jete një njeri i respektuar që do të kujtohet e nderohet nga brezi i vet, nga shokët e bashkëpunëtorët, do të mbetet përherë i gjallë në kujtimet e familjes e fëmijëve të tij. Në të vërtetë, është larguar nga kjo jete një prej shokëve tanë më të mire dhe në moshën më të papërshtatshme.

Nikollë Vocaj i përketë një brezi dhe profesioni që luftuan e punuan një jete të tërë për njerëzit dhe me njerëzit. Jeta e tij, ashtu si e gjithë gjeneratës së formuar në vitet '70, ishte jeta e një brezi bohemësh, e një plejade kuadrosh e specialistesh, që shkruanë energjitë e tyre në rrugët e atdheut, duke jetuar dimrin e gjatë të ëndrrës për një të ardhme më të mire.

Nikollë Voci ka dhënë për një kohë të gjatë një kontribut evident në zonën e Bregut të Matës dhe mbetet një nder përfaqësuesit më solid të saj, njeri i dashur e i respektuar. Ai ishte shembull i harmonizimit të urtësisë e mençurisë me dijet e kohës, çka e ka bere atë të respektuar nga të gjithë.

Populli Zejmenit, Balldrenit dhe i Lezhës do ta kujtojnë përherë Nikollën si një nder kuadrosh e vet më të zotë, si një nga bijtë më të mire dhe nder burrat e nderuar. Shokët e koleget do ta kujtojnë Nikollën për fjalën e urte e këshillën e mençur. Miqtë dhe të afërmit do ta kujtojnë atë, sepse i donte dhe i respektonte se, ishte i drejte dhe fjale ëmbël. Familja dhe fëmijët do ta kujtojnë përjetë për rrugën që u ka dhënë në jetë, për urtësinë e treguar në edukimin e tyre.

Me lot nder sy ne, po ndahemi sot prej tij, por kujtimi, emri dhe fjala e tij do të na shoqërojnë gjithmonë.

Për familjen, shokët, miqtë dhe bashkëpunëtorët humbja është shume e madhe, dhimbja e thelle dhe përlojtja e justifikuar, por të mbahemi të forte për humbjen e parakohshme të këtij shoku e miku të pazëvendësueshëm.

Ju ftoj, të mbajmë një minute heshtje, në nderim të këtij burri të nderuar, shoku të dashur e prindi të devotshëm!

Përjetë kujtimi i tij!

I lehte të qofte dheu mbi varr dhe e bardhe rruga për në jetën e pasosur o miku dhe shoku ynë i paharruar Nikollë Vocaj!

humbur nga humbja e Nikollës, por Nikolla me jetën dhe veprimtarinë e tij ka mbetur gjallë.

Lamtumirë Nikolla ynë i dashur, Nikolla ynë i mirë!

Të qoftë dheu i lehtë dhe push-

ofsh në paqe! Zoti e bekoftë familjen tënde!

Gjergj Leqezja, Dede Marashi, Luigj Shyti, Pal Lera, Mark Kulla, Mirash Ftoni e Fran Marku

A po shtiremi si shumë në këtë Nëntorin e madh

Garë se kush po duket më shumë e po flet më bukur.

Nuk po bëhet dasmë, konagjegj, syneti as pagëzim i një fëmije e në dollinë e ngritur të mos thuhet nga folësi se ky aheng po zhvillohet në kuadër të 100 vjetorit të Pavarësisë. A po shtiremi si shumë në këtë Nëntorin e madh? A nuk po zhvillohet

garë se kush po duket më shumë e po flet më bukur?

Këtyre dy pyetjeve po ia shtoj një pyetje shtesë se, a kanë çfarë të përgjigjen këta që po turren në këtë Nëntor kur dikush do pyes se a kanë bërë diçka për kombin në 10 muajt e kaluar të këtij viti jubilar për kombin e mos të kthehemi në vitet e shkuara?! Përgjigja do të ishte e varfër dhe do të kërkonte hulumtime e dënime për kameleonët që nuk e bën as këmbën e miut për kombin në gjithë këto muajt e vite e tani janë në vrap dhe me "zjarrin" në zemër për atdheun e kombin duan të mbesin në analet

historike të këtij Përvjetori të madh. Po janë të mençur këta se me vite kanë heshtur dhe tani kur janë ndezur kamerat i kanë herifat paratë dhe bëjnë e çka nuk bëjnë për t'u parë e për të treguar "atdhedashurinë" e tyre. Flamurin, kombin, gjuhën dhe atdheun e kishim obligim ta donim e dëshmorët t'i nderonim gjatë gjithë kohës dhe dihet se e kemi kryer këtë obligim. Për bashkimin e kombit është dashur të punojmë gjithmonë e dihet se, sa e kush u angazhua. Dihet edhe se, sa kush u ndihmua e u pengua. Angazhimet me aq ngulm të shumë njerëzve e ca institucione-

ve në këtë Nëntor po m'i ngjasojnë ca individëve që për 11 muajt nuk lënë gjë pa bërë e kur vjen muaji i shenjtë i Ramazanit shkojnë në xhami, mbajnë tespi e flasin fjalë të bukura nga Kurani. Nëntor i madh dije se, disa po të mashtrajnë sepse edhe në 100 vjetorin tënd të madh, jo që nuk u bë gjë për bashkim e unifikim, por u punua shumë për të injoruar angazhimet e individëve e shoqatave që mundoheshin të bënin, qoftë edhe një hap, drejt Bashkimit.

Po vazhdojnë shtirjet edhe në këtë Nëntor dhe dhjetori do të dëshmojë se, ishte kjo një garë

se, kush po duket më shumë e po flet më bukur e Malësia, Kosova Lindore e trojet e tjera etnike do të vazhdojnë për të frymuar vështirë. Do të vazhdojnë të ndjehen të pambrojtur edhe pse ky Nëntor shqiptarët i gjeti e po i lë më dy shtete. Mos më besoni mua lexues të dashur po pyesni ata që u burgosen e u torturuan nga Podgorica e Beogradi me fajin vetëm pse ishin shqiptarë. Reagoni e më thoni çfarë t'u vjen në gojë pasi të flisni me ta. E deri atëherë Ju lus mos të shtirimi si shumë në këtë Nëntor të madh.

Nga Rrahman Jasharaj

GJERGJ KASTRIOTI NË DAKAJ- SHALË

-558 VJET MË PARË-

Nga Luigi Shyti

Në krahun e djathë të lumit të Shalës, rreth një orë në këmbë, mbi një shkëmb, duken rrënojat e një kështjelle që quhet Kalaja e Dakajve dhe shpesh thuhet se është mesjetare. Duke u menduar më thellë mund të bindemi se kjo kështjellë, si edhe të tjera, edhe në Dukagjin, duhet të kenë një zanafille shumë më të hershme. Në një reviste të përmuajshme, vite më parë shkruhet "... Qyteti i Dakajve ... pikërisht këtu ilirët dhe më vonë pasardhësit e tyre në mesjetë ngiten mure aq të fortë sa që edhe sot qëndrojnë ... plotë gjallëri". Në periudhën e pushtimeve osmane popullsia e territorit të Shalës dhe Dukagjinit nuk ka qenë aq e madhe sa të mund të ndërtojë kështjella të tilla, nuk kemi një dinasti të fuqishme të njohur që të kishte mundësinë e organizimit dhe ndërtimit të tyre. Natyrisht ndërtimi i këtyre kështjellave tregon se kjo zonë dhe këto territore kanë pasur interesimin e ndonjë pushtuesi për të ndërtuar vend mbrojtjeje të fuqishme. Do të vlen të shkenca arkeologjike të hulumtojnë këto qyteza, këto kështjella dhe të nxjerrë përfundimet shkencore, të cilat janë në gramat e fundit dhe po vdesin shumë shpejt. Ndërtimi i kështjellave në territorin e Dukagjinit ka edhe më shumë rëndësi që të hulumtohen edhe për faktin që vitet e fundit është vërtetuar në Theth një vendbanim rreth 3000 vjeçar. Ky vendbanim dhe të dhënat rreth tij besoj se do të ndihmojnë në saktësimin e ndërtimit të kështjellave konkretisht në Shalë, Qeresh të Plani, ne Mguille dhe në Kirë, por ka edhe të tjera vende që populli i quan "qyteza" ose "forca" apo vendbanime kishtare.

"Sot, ndonëse e rrënuar, dallohen në të dhe gjurmë para mesjetare të një përforcimi ilir" – shkruan historiani K. Ulqini.

Në kohë të mesjetës këto territore thirreshin Pult, i cili kishte një shtrirje mjaftë të gjerë që nga bregu i Liqenit të Shkodrës përfshirë deri edhe pellgun e Drinit të Bardhë. Në shekullin e XV këto territore sundoheshin nga familja Spani. Pjetër Spani, pjesëmarrës në Kuvendin e Lezhës në vitin 1444 me katër djemtë e tij, siç thotë M. Barleti "pothuaj vërsnikë dhe që i ngjanin njëri-tjetrit nga trupi dhe karakteri". Ndërsa Fan Noli e quante Pjetër Spanin Kapedan i Shalës e Shoshit. Ata ishin aktiv nën prijën e Gjergj Kastriotit kundër pushtuesit Osman. Por ndonjë herë edhe dolën nga aleanca dhe u lidhen me Venediku, duke u rikthyer përsëri.

Pas vdekjes së Pjetër Spanit, djemtë e tij filluan grindjet, kështu edhe populli u përça dhe filloj të ngrinin krye kundër

feudalëve të tyre, që mbase është edhe e para kryengritje antifeudale të asaj periudhe. Autori që ka sjellë të dhëna në lidhje me këto ka qenë G. Biemi në botimin e tij "Istoria di Giorgio Castrioto derto Scander-begh, Brescia, 1742, faqe 330" (cituar nga K. Ulqini).

Gjergj Kastrioti në vitin 1453 thyen në Fushën e Pollogut ushtritë osmane nën komandën e Ibrahim Beut, dhe pas kësaj pati një farë kohe të lirë, që të merrej me punët e brendshme të vendit të tij. Në këtë kohë ishte bërë pajtimi edhe me Dukagjinët si dhe disa feudal të tjerë. Në këto kushte Gjergj Kastrioti, i ftuar dhe me ndërmjetësinë e peshkopit të Drishtit për të pajtuar gjendjen në principatën e Spanëve, gjeti mundësinë të merrej me Spanët dhe shkoj në "Qytetin e Shalës dhe Shoshit" në dhjetor të vitit 1454. Sipas komenteve të bëra edhe nga K. Ulqini, G. Biemi nuk jep hollësitë e rrugës së shkuarjes së Gj. Kastriotit në Shalë, por më e mundshme ishte Mat-Mirditë-Pukë-Vaun e Dushmanit dhe nëpër Luginën e lumit të Shalës të mund të arrinte në "qytetin e Shalës dhe Shoshit". Në atë kohë kjo njihet edhe si Kështjella e Mavriqit.

Me të arritur Gjergj Kastrioti, me autoritetin e tij paqësor gjendjen, duke marrë edhe masa për djalit e Pjetër Spanit si shkaktar i trazirave në këtë territor.

Që nga ky moment Principata e Spanëve vjen duke u shuar, por shumë gjatë mbeten toponime, si "Malet e Spanëve", "Krahina e Spanëve", e të tjera. Nga familja Spani kanë dalë edhe luftëtarë dhe komandantë të zotët, siç qe Marin Spani, që Marin Barleti e cilësonte "Burrë epirot besnikërie të sprovuar" e që Gjergj Kastrioti e emron në krye të Kështjellës së Drishtit.

U mbushën 558 vjet nga kjo vizitë e Heroit Tonë Kombëtar Gjergj Kastrioti, në Puktin e Vogel, ose të Poshtëm, sot Dukagjin. Kjo vizitë historike meriton përkujtim dhe respekt.

Kështjellat dhe mbetjet e tyre në Dukagjin, ashtu edhe në vende të tjera, meritojnë shumë më tepër vëmendje nga të gjithë instancat shtetërore, për restaurimin e tyre por edhe për kthimin e tyre në një vend turistik, që vizitorët të njihen me kulturën dhe historinë në këto monumente dhe përreth tyre, me punën e njerëzve në kohë të ndryshme, ecurinë e kulturës dhe zhvillimin e tyre.

Kështjellat janë si çerdhe të përzgjedhura dhe të sigurta që njerëzit kanë zgjedhur për të rritur zogjtë e vet, për tu mbrojtur, për të jetuar.

Strukturat e qeverisjes vendore, veçanërisht, mund dhe duhet që të bëjnë përpjekje më shumë për këto qendra të historisë dhe kulturës që të bëhen më të mundshme për tu vizituar, të kenë shenja treguese për lëvizjen e vizitorëve, të dhënë historike, gjeografike e pse jo edhe më gjerë. Këto duan më shumë vëmendje, pavarësisht punëve të shumta që u marrin kohën, por gjithsesi duhet gjetur mënyra e të mos lihen pas dore, sepse brenda tyre është histori, kulturë, shkencë, turizëm dhe zhvillim, është kujtesë nga e kaluara që i shërben të ardhmes.

PËRSHKRIME DHE MBRESA

-VJET MBAS BOTIMIT TË ROMANIT "ZEMRA E NËNËS" KUSHTUAR LUFTËS HEROIKE TË POPULLIT TË KOSOVËS, QË U SHKRUAR NË ZJARRIN E LUFTËS NË VITET 1998-1999-SHKOVA NË KOSOVË-

Qershor 2012, me shokun tim Ndue Sanaj, vendosem për të bere një udhëtim drejt Kosovës, për të pare dhe përshkruar realisht ndryshimet e bëra gjate këtyre viteve të pas luftës, në disa drejtime.

Unë, në fakt kam ardhur këtu edhe gjashte-shtate here të tjera që nga koha e luftës kur shkrova romanin. Në prill 2006, isha në Prishtinë, në Prizren e disa qytete të tjera, ku nder të tjera shume koleg të mi shkrimtar apo intelektual të fushave të ndryshme, apo lexues të thjeshte të librave të mi, duke përfshirë edhe personazhe të romanit "Zemra e Nënës", mu luten që ketë roman ta ribotoj së bashku edhe me disa shtesa apo përmirësime. Dhe menjëherë atë bëra, duke lënë çdo pune tjetër që kisha në dore.

Unë, së bashku me Nduen, ditën e pare të vizitës tone në Kosove, u ndalem në kryeqytetin e Tij, Prishtinë. Këtu ka ndryshuar gjithçka për mire. Duket se, këtu njerëzit kane një fryme, arrijte tjetër në vendin e tyre të lire dhe sovran, në shtetin e tyre demokratik e të tjera ...

Oh, sa gjak i kuq si Rubini, sa vuajtje e sakrifica u deshtë për të ardhur deri këtu ...! Por sa pune duhet për të shkruar deri atje ku duhet edhe në të ardhmen, për të çuar Kosovën atje ku e meriton, në Bashkimin Evropiane e në organizmat e tjera ndërnacionale ...

Fitorja më e madhe që u shënua mbas luftime, ishte shpallja e shtetit të pare demokratik, Kushtetuta e re, dhe njohja e mbi 145 shteteve të para, Kosovën si Republike të Pavarur e Demokratike dhe shume shtete të tjera po behet gati ta njohin atë.

Me Hajron, ku me makine, por të shumtën edhe në këmbë shëtisim anë e kënd Prishtinën e bukur, tashme pa serbin pushtues, pa Slloban Millosheviçin, Arkanin e të tjera, të cilët nuk jetojnë më. Një shprehje e popullit thotë: "Mos i lashte as varri brenda ...".

Edhe në orët e vona të natës, në rrugët e Prishtinës ka shume njerëz, shume lëvizje. Djemtë e vajzat e reja kthehen në shtëpitë e tyre mbas mesit të natës, dhe bulevardit është i mbushur plote. Kjo të kujton festat e dikurshme në Shqipëri. Në fakt është një feste e kuptueshme, e cila vijon prej ditësh, që kur lufta mbaroi, dhe ushtria serbe e shkatërruar e koke-ulur u tërhoq e mundur nga Kosova, nga UÇK-ja heroike, që dikur patën guximin edhe disa shqipfolës ta etiketonin atë si "grupe terroriste" e të tjera, e të tjera. Por populli i Kosovës i ka njohur ata që s'janë më, por edhe ata që janë, por një fjale e urte thotë: "Vetëm trimat falin ...".

Xhiroja e natës, që vijon deri në orët e vona nga njerëz të gëzuar e të lumtur për të ardhmen e Kosovës, i thonë "korse", është një nga shenjat e para të rivalizimit të shpejte të Kosovës. Dhe ketë feste të zgjatur nuk e takon vetëm në Prishtinë, por në të gjitha qytetet e Kosovës. Kur ne, lame Podujevën ora po shkonte 22.00, por rrugët ishin serish plote, me gjithë mungesën e ndriçimit publik, për shkak të një defekti elektrik në të gjithë Kosovën. Ne, na vinte të qeshnim me preokupimin e madh të miqve tanë kosovare për mungesën e përkohshme të korrentit dhe të ujite. Të pamësuar më pare për problemet tona të përditshme, të shqiptareve të Kosovës, u dukeshin gjera shume të rende çrregullimet e kuptueshme të pas luftës.

-Kuptova me trishtim më thotë Ndueja se, pikërisht në ketë ore, unë kthehem nga puna për në shtëpi, duke kaluar nëpërmes rrugëve disi të shkreta të qytetit e të fshatit, pa drita e pa lëvizje të shumta njerëzish. Është vërtet për të ardhur keq që, në Shqipërinë tone prej dhjetëra e dhjetëra vitesh ndihesh, që akoma në çdo hap ndeshesh me gjurmët e "luftës"! Një miku i ynë kosovare, -na thotë me shaka se, Kosova është serish e "pushtuar", por ketë radhe nga miqtë e saj që fatmirësisht e gjene në çdo rrugë. "Pushtuesit" janë ushtaret e KFOR-it, prezenca e tyre të kujton nga njëra ane se, lufta ka mbaruar, por edhe atë nga ana tjetër se, paqja në Kosove është ende e brishte.

Por "krosa" e mbrëmjes, ka edhe simbolike tjetër, atë të thyerjes së mitit të Prishtinës me kufij të forte mes serbeve dhe shqiptareve. Në shëtitoren e qytetit, dikur ka qene rreptësisht e përcaktuar qarkullimi i serbeve në njërin ane të rrugës dhe i shqiptareve në anën tjetër të rrugës.

(vijon në numrin e ardhshëm)



POPULLI MË I VJETËR I BALLKANIT PA DYSHIM ËSHTË POPULLI SHQIPTAR, I CILI NË KOHËRAT E VJETRA PREJ ADRIATIKUT DERI NË DANUB, TUE PËRFSHI EDHE UNGARINË PERËNDIMORE

Kur prof Ibrahim Kelmendi ka shpalosur idetë e tij, ndërkohë ka hedhur teza të guximshme për prejardhjen e shqiptarëve, ka qenë viti 1950. Duke shfletuar gazetën: "Flamuri", botohej në Romë nga emigracioni politik shqiptar, gjejmë një seri shkrimesh të prof I. Kelmendit që kanë gjuhën, mendjen dhe vlerësimin e tij për gjenezën e kombit më të hershëm në Europë. Nuk janë thjeshtë citime, por një analizë sintezë me fakte e dokumente që sillen të reja. Në këtë gjurmë 50 vite me vonesë shumë studiues shqiptarë po sjellin atë çka prof I. Kelmendi dhe të tjerë i kanë bërë të njohura, por që nuk janë njohur brenda kufijve të Shqipërisë për me të vetmin shkak thelbësor, regjimi. Populli më i vjetër i Ballkanit pa dyshim është populli shqiptar, i cili në kohërat e vjetra prej Adriatikut deri në Danub, tue përfshi edhe Ungarinë Perëndimore shprehet prof Kelmendi. Të parët e tij quheshin ilirë. Këta qenë ndër arianët më të parë që patën ardhje në Europë. Vendi i tyre quhej Iliri. Për Ilirët prof Kelmendi ka bërë të njohur teza të autorëve të antikitetit. Për ardhjen e tyre nuk ekziston ndonjë datë e saktë, çohet deri në shekullin XX përpara Krishti. Prof Kelmendi merr dhe citon Herodotin. Që i quan barbarë dhe thotë se u ngjanin thrakasvet. Të këtij mendimi kanë qenë edhe shkrimtarë të moçëm grekë.

Pamja fizike: Prof Kelmendi reshton këto tipare: Ilirët kishin trup të gjatë, muskulaturë të vogël, inteligjencë të qartë, energjikë dhe luftëtarë shumë të mirë. Flokët dhe sytë e zj. Paganizmi: Besojshin në shumë perëndi: Medaurus, Binaus, Latra, Seutona etj.

Pozita shoqërore dhe politike e gruas: Prof Kelmendi jep një të dhënë të rëndësishme që pak njihet dhe është bere objekt. Gruaja në shoqënin ilirvet gëzonte konsideratë të mirë. Ushtronte edhe pushtet politik dhe në mes të sundimtarëve të Ilirisë gjejmë edhe mbretëresha. Sikurse tek indoevropianët e tjerë edhe këta në altarin e perëndisë sakrifkofshin. Jetonin ma shumë prej gjuetisë.

Raca: Të të njëjtit gjak e gjuhe ishin edhe epirotët. Stabroni thotë se Ilirët, Epirotët dhe Maqedonasit flitnin një gjuhë. Shumë



shkrimtarë modernë thonë se kultura greke ndër maqedonasit ka qenë e sipërfaqshme. Pra shprehet Kelmendi, nënshtetasit dhe luftëtarët e Filipit, dhe të Aleksandrit që mbritën në Hindi dhe ndër piramidat, flitshin gjuhën nane të shqipes së sotme.

Fiset ilire: Ilirët kanë qenë të ndarë në fise: Ardianët, Laebetët, Liburnët, Autoariatet, Dalmatët, Dradhanët, Venetët si dhe mesapët dhe japuget që banojshin në pjesën e jugut të gadishullit italian. Përveç këtyre kishte edhe fise të tjera. Ky fenomen shpjegohet vetëm me përbamjen dhe natyrën e vendit ku banonin.

Dëshmi e ilirëve në tempullin e Delphit: Prof Kelmendi sjell një të dhënë të Herodotit. Herodoti thote se ata patën mesue edhe tempullin e Delphit. Prezencën e shqiptarëve në rranxë të Akropolit të Athinës (Plaka lagjja ma e vjetër e këtij qyteti) e çojnë në kohna shumë të vjetra dhe mbështesin në një varg të Thuqidhidit ku ban fjalë për një popullatë barbare me rranjet t' Akropolit ku ende sot ndigjohet një shqipe e gjymtueme. Bërthama e shtetit ilir: Bërthama më serioze e njei shteti Ilirian qe fisi i Ardianvet. Me autariatet, Labeatet, Liburnet, e fise të tjera, krijuan një shtet, i cili në shekullin e IV

pr Kr, u ba shtet glorioz. Kryeqyteti i këtij shteti u bë Shkodra. Për tu mbrojtur nga keltët, qysh në fillim të shekullit të IV pr. Kr, rreth bërthamës së përmendun u mbështuallën të gjithë fiset që prej Trieste e deri në Arte dhe kështu u krijua mbretëria ma e madhe e Ilirvet nden Mbretin Bardhyl. Mos ta harrojmë se ka historianë që jetën shtetnore të Ilirvet e çojnë qysh ne shekullin XII, pr. Kr. Më 385 Bardhyli mundi mbretin Amintas të Maqedhonisë, ia pushtoi pjesët perëndimore të shtetit dhe detyroi të paguante haraç. Filipi i II e mundi Bardhylin dhe i pushtoi të gjitha krahinat deri në Ohër tue i aneksue në shtetin e vet. Mbas vdekjes së e Bardhylit, shumë fise u tërhoqën në jetën lokale dhe kështu filloi bjerrja fatale e Ilirvet.

Dardanët: Koncepti që ka dhënë për këtë fis prof I. Kelmendi. "Ndër fiset e Ilirvet, ma i madhi qe fisi i Dardhanet. Vendi i tyre ishte Kosova e sodme deri në Nish dhe në Jug, në Vardarin e Sipërm deri në afrësinat e Manastirit. Kryeqyteti i Dardhanis ishte Shkupi i cili quhej atehere Skupi (Scupi). Vehej në dukje bukuria e gravet të tyre. Edhe sot ka mbete në Kosovë e në vende të tjera, kur duen të ekzaltojnë bukurinë e ndoqi femre thonë: "QQenka si Dardhane". Jo rallë e ndien njeriu këtë krahasim në raste të tilla në Greqi, ku sigurisht ka mbete qysh prej kohnavet të lashta.

Luftëtarë: Dardhanet përmenden si luftëtarë të mirë dhe rezistenca e tyre kundër maqedhonasvet e romakvet asht e ndigjueme.

Detarë të zotë: Ilirët kanë qenë të zotet edhe si detar. Tregtia e grekvet në Adriatik pësonte dëme të mëdha nga kusarët etyre. Për të siguruar tregëtinë, grekët e ftuan Romën për ta qetësue Adriatikut nga iliret.

Luftërat me Romen: Në vjetin 228 pr Kr u pa zbarkimi i parë i romakvet në Iliri, që sundohej asi kohe në pjesë të madhe prej mbertëreshës Teuta. Lutfa nuk përfundoi me një a dy beteja, por zgjati ma shumë se dy shekuj. Më 168 pr. Kr. konsulli romak Lucius Anicus kaloi si rrefe nëpër Iliri dhe pushtoi Shkodrën dhe në kalanë e saj zuni rob mbretin Gencius, të cilin bashkë me të shoqen Etleven dhe dy të bijtë e

dërgoi në Romë, për të stolisur kthimin e tij trimfal. Mbas këtij suksezi Ilira u shpall provincë e Romes. Por në realitet lufta nuk pushoi aspak. Ilirët bëjshin vazhdimisht kryengritje. Sa pushonte a shtypej në njannën fishkullonte në tjetrën. Ma e njoftuna është kryengritja e kryesume prej Batos e cila qe përhap në krejt Ilirinë. Kjo lëvizje e mnerrsheme përmendet me emnin: "Bellum Batonianum (6-8 mb Kr.). Luftërat me iliret, Romë i kanë kushtue shumë shtrenjtë si në njerëz ashtu edhe në material. As një popull nuk i ka qëndrue fuqivet të saja aq sa i kanë rezistue Ilirët. Ma vonë kur në Ilir u stabilizua qetësia, ilirët i suallën Romë edhe shërbime të konsiderueshme. Lagjionet më të mira ajo i rekrutonte në Iliri dhe gjeneralët Ilirianë luftuan në Britani, Rhin, dhe në Eufrat. Nga katundarët Iliriane duallën edhe perandorë si: Claudius, Aurelian, Probus, Dioclecian, Maximian, Konstandini i madh.

Zbulimet arkeologjike dëshmojnë: Për të mujte me formue një ide të qartë mbi qytetimin e ilirvet nuk janë të bollshme dokumnetat e shkrueme. Por zbulimet arkeologjike në Bosnje. Dalmaci e Kroaci na apin prova binëse për qënien e një qytetërimi të naltë ndër ilirë. Për të kursyer fjalët po përmendim një pjesës nga enciclopedia Britanica "Në Bosnje, banesat e liqenit në Butmir, vorrezat e Jezerinës e të Glosinac si dhe vende të tjera kanë ruajte orendi prej guri dhe prej brini, zbukurime prej bronxi e prej hekuri, armë etj si dhe sende ma të vonshme prej argjendi, teneqeje, qelibari e madje edhe prej qelqi. Të gjitha këto na tregojnë periudhat e ndryshme të qytetërimit primitiv të Iliranvet qysh prej kohevet neolithike e këndeje. Sidomos kulturat Hallstatt dhe La Tene paraqiten veçanërisht ma së miri. Po të tilla zbulime janë bamun edhe në Dlamaci e në Kroaci-slavoni... Kristainizmi tek ilirët: Prof I. Kelmendi përmend faktin se ilirët ishin ndër të parët popuj në Evropë që erdhën ne kontakt me Kristanizmin. Në vitin 53 Shën Pavli predikoi Ungjillin ndër ilirët, ndërsa 4 vjet më vonë nxënësi i tij Titus. Ne shekullin e V-VI, Durrësi dhe Nikopoli u bën qendrat më të forta të kristianizmit në Iliri. Mbas tyre vinte Shkodra, Tivari. Në kohën e Justinianit Shkupi u bë kryeqyteti moral dhe administrativ i krejt Ilirisë. Studimi i prof Ibrahim Kelmendit përvijohet me principatat dhe me tej për gjenezene tone dhe ardhjet sllave ne Ballkan me periudhat e mëvonshme që zënë vend në historinë e këtij kombi të hershëm sa vet kontinenti ynë.

Nga Paulo Tedecchini

Askush nuk duhet te beje agjitacion islamik pa denuar masakrat e terorizmit Islamik, qe behen ne emer te Islamit, Kuranit dhe Allahut

Nga VEDAT SHEHU,
gjeolog – Dr, Inxh. Prof.

Fundamentalizmi i cdo feje duhet luftuar nga vete fetaret, sidomos kleriket perkates, me qendrimet konkrete, duke orientuar te gjithëbesimtarët dhe opinionin, peer te bere te ditur publikisht se, misioni i feve eshte qe seicila t'a perqendroj synimin ndaj harmonise njerezore ndaj te njejtimit simbol te njeriezimit mbar,qe shqip nuk quhet as Allah, as Dio dhe as Jehovah. Kush i thot Perendise emer tjetere dhe vec emerit Zot, nuk mund te quhet, nga Shqiptaret, Shqiptar. Me dengela anti shqiptare, ne emer te njerës apo tjetres fe, Shqiptaret jane ngopur. Keto dengela, ne emer te kesaj apo asaj Perendie apo Qendre te Shenjte, fshehin politikat e fsheheta per

qellime sundimi dhe ekspansiniste mbi cilindo shtet apo territor Shqiptarësh. Kesaj politike i sherben cdo propagandist fetar. Ne kete pike sovraniteti kombetar, cdo Shqiptar duhet te ruaj dinjitetin permby politikizimet fetare, rrezikun e te cilave na i ka mesuar Rilindasi i Madh Pashko Vas Shkodrani. Nje propagandist fetar eshte sherbetor i politikave qe ne emer te fese shprehin urretje fetare, te ngjashme me ate qe beri Hitleri kunder cifuteve (ne fakt shfrytëzoi urretjen e mbjellur nga agjitacioni kristian kunder cifuteve per te ndersyer opinionin); te njejtën gje beri Napolon Zerva kunder Shqiptareve ne Greqi dhe po ashtu Miloshevicu kunder Boshnjakeve dhe Shqiptareve ne Ish Jugosllavi.

Sot, ne kuadrin e botes se jashtme, me i

neveritshmi, nga tere fundamentalizmat e shprehura ne Histori, eshte bere Fundamentalizmi islamik qe ka kaluar ne akte sadiste sekrete dhe banditeske, ne menyreen me te pakuptimte, ne emer te Kuranit dhe Allahut. Askush nuk do t'i besonte se keto aksione gjakatare kane origjine hyjnore. Cilido kamikaz eshte i rekrutuar me mashtrime, shantazhe, intriga dhe me para te thata si ushtar i derguar ne front, qe po ta beje nje hap mbrapsht, vritet ne vend nga praparoja. Ky fundamentalizem eshte i pashembullte ne histori, per te vetmen arsye se behet me aksione sekrete te perbetuara ne emer te Allahut dhe kryejne masakra masive aty ku s'ta pret mendia. Cilido e di, se sa poshtrohet vete nje udhetar nga kontrolltet e imta te trupit, per t'u mbrojtur nga keta xhelate qe ia kane dhene shpirtin djallit dhe tallen me opinionin, sikur bien fli me urdhera te Allahut.

Prandaj Zoti Agon, ne se ju me te vertete doni te shprehni Agon e nje qytetrimi cilesor,

nuk mund t'a beni kete, te shkeputur nga vepre madheshtore e Heroit Kombetar, vepreprimaria e Rilindasve dhe vyrtetet tradicionale kombetare, kulturore; si dhe nuk mund t'a veconi qellimin tuaj nga predispozimi i Shqiptareve per dituri, shkence dhe teknologji. Atehere, sikurse ju, kushdo qofte tjetere, klerik islamik, bashk me besimin e tij tek Perendia dhe Kurani, sigurish i perkthyer Shqip ne cdo term, se pari do t duhej te denonte konkretisht ashper aksionet gjakatare qe bejne koleget e tij fundamentaliste te Lindjes Islamike (klerik dhe te tjeshte te rekrutuar).

Askush nuk duhet te beje agjitacion islamik, pa denuar masakrat e epokes sone; makabre, gjakatare te terorizmit Islamik qee behen shpallen me buje ne emer te Islamit, Kuranit dhe Allahut.

Marre nga gazeta "Tribuna Shqiptare",
date 23 tetor 2012

KOMPOZIMI I VEÇANTE I NJE LIBRI

(Referat në promovimin e librit "Përthyerje e dritës së shpirtit" të autorit Tonin Vasa).

Ne, njerëzit ndodhemi çdo ditë përpara dhjetra e qindra zgjedhjeve, të cilat na i afron jeta, koha dhe nevojat. Të zgjedhësh për të bërë atë që di të bësh është zotësi dhe vetëdije, pushtet mbi vetveten dhe vlerë shoqërore. Ndër të gjitha zgjedhjet, unë e mendoj se të dish me zgjedh fjalën e duhur në kohën e duhur është më e vështira ndër të gjitha. Në librin "Përthyerja e dritës së shpirtit" të autorit Tonin Vasa kjo pa më të voglin dyshim është arritur në një shkallë mjaft të lartë. Autori e kursen fjalën, e përkëdhel atë, e vendosë aty ku duhet, aty ku spërndrit dhe krijon imazh rrethanor, aty ku vallëzon midis shoqeve të tjera, aty ku nuk krijon konfuzion, aty ku qëndron larg neotizmit, sepse fjala është e dhimbshme, është

lematikë që shpeshherë kthehet në rutinë. Kërcimet do t'i quaja Pindareske, nga ngjarje tek personazhe nga personazhe tek fejtone e nga fejtone tek shenime udhëtimi e të gjitha keto së bashku e kanë bërë librin shumë



dhe limfën e duhur për të ushqyer sistemin tonë elektromagnetik brenda ndjenjave. Unë autorin e konsideroj si një përurje të ndërgegjegës Prustiane me prurje të përhershme, ndërsa në pozicionimin filozofik si pjesë e devizës Karteziane "Mendoj...pra jam!". Të dyja këto në integritet me njëra-tjetrën i kanë dhënë atij satisfaksionin intelektual të të parit në zonat e thella të reales në krijimin e një realiteti të ri, që është pjesë e subjektivit, shpirtit të tij. E veçanta e këtij libri është se autori hidhet nga një problem në tjetrin, nga një situatë dhimbjeje, në një atmosferë feste, nga një shpërthim lirik në deskriptivin e një udhëpërshkrimi, dhe të gjitha këto prodhojnë idenë se njeriu nuk është një shablon i rendomtë, por një qenie komplekse e hyjnore dhe e natyrore dhe si i tillë vija emocionale përkulet

in e këpucës për t'u rregulluar. Tek "Eklipsi i diellit" nëpërmes një paralelizmit figurativ ekspozon ndikimin e natyrës mbi ne, dëshiren e ngasjen e njeriut për të zbuluar thellësinë e humnerës, misterin, por edhe frikën prej saj. Raportet me nxënësit e tij i jep nëpërmjet një shkrimi vërtetë emocional e drithërues. Falë punës së tij të përkushtuar në arsim dhe erudicionit të gjërë, mund të them se është një psikologjisje prej profesionisti të shkëlqyer. Autori, megjithëse është për ndryshimin e modernen, ai kurrsesi nuk do ta fshijë tradicionalen. Atë e joshë ambient malësor me një sfond disi legjendar-thotë Koliqi. Për këtë nuk mungon as deduksioni filozofik: "Koha nuk është e mirë as e keqe... Është thjeshtë kohë". Si admirues e zbatues i tre postulateve biblike: dashuri, besim, mirësi, autori përmes një poezie lirike i thur himn dashurisë, dhe këtë e realizon nëpërmes të kundërtes: padashurisë dhe stilistikisht përmes anaforave dhe klimaksit.

-Dy vargje filozofike të Jozef Kiplingut: -Në mund ta ruash arsyen, kur bota humbet fillin/-E fajin ta hedh ty-dhe vetes t'i besosh, konvertohet në një shkrim që do ta quaja: prozë poetike, ku çdo fjalë ka peshë, emocion, domethënie duke krijuar kështu një ngjeshje kuptimore me denduri të rrallë. Nëpërmes një dialogu të shkurtër autori jep pikëpamjet e ndryshme për jetën ndërmjet dy bashkëbiseduesve, ku njëri

është vetë, dhe produkti është sentenca e tij: "Endërrimi është embrioni i krijimit, udhëtimi është udhëshkrimi i ëndrrës. Me një argumentim të admirueshëm autori na jep projekcionin e njeriut mbi drejtëzen e kohës, apo figurën e bukur të rrethit dhe shpjegimin sociologjik matematikor, duke arritur në përfundimin: "Teoremat matematike nuk janë asgjë tjetër, veçse lidhjet sociologjike". Në këtë libër nuk mungojnë as shkrimet fantastiko-shkencore, duke na kujtuar kështu Zhyl Vernin apo Frederik Braunin. Ky lloj shkrimi është pronë e njerëzve me njohuri të thella shkencore e me fantazi gati hyjnore. Fejtoni, si lloj i vështirë letrar, zë një pjesë të këtij libri. Aq sa janë interesant titujt, ku do të veçoja fejtonein "Arti i tetë" ose kompozita neologjiste "SPIUNARTI", po aq interesante është brendia e tyre. Këtu del qartazi se dekadencia e sistemit sjell dekadencën e shoqërisë dhe berthamës së saj, familjes. Autori nëpërmes disharmonisë, disproporcionit, ç'ekuilibrit na kujton stilin Pirandelian, apo të quajturën "Poetikë e humorizmit". Ne kur takojmë gjëra të mira, siç është ky libër, ndjehemi mirë dhe shikojmë nga e ardhmja, por rrimë edhe me 'veshë në krah' - siç i thonë fjalës, për prurje të reja të autorit me qellim që të pasurojë e vegjetojë krijimtarinë e tij dhe njëkohsisht lamin e kulturës shkodrane.

Shkoder, me 8 Dhjetor 2012
LAZER KODRA

MBRET APO TRADHËTAR I SHQIPETARVE?



Ahmet Zogu ka lindur në Mat, rrjedhe nga një familje feudalesh. U shkollua jashtë shtetit. Mbas mbarimit të luftës së Ballkanit e largimit të Turqisë, Evropa dergoi në Shqipëri Princ Vidin, pasi kishte mungesë kuadri të pregatitur. Nga çrregullimet e mosmarrveshjet e brendëshme, ai i largua. Pas tij erdhi Sulejman Delvina, qellimi i të cilit ishte formimi i një qeverie demokratike të pavarur, ku u mblodhen të gjithë studentet e asaj kohe si: Ndokë Gjeloşi, Ahmet Zogu, Sejfulla Vllamasi nga Kolonja Azis Çami nga Çamëria e shumë të tjerë që ndihmuan Sulejman Delvinën për krijimin e qeverisë, detyrë që e mori përsiper A. Zogu nga që ishte

edhe vetë feudal dhe po kështu edhe burrin motres nga Kosova feudal, ishte fejuar me vajzën e Shefqet Verlacit, i cili kishte një pjesë të madhe të Shqipërisë së mesme. I nisur nga kjo prejardhje feudalesh u mbështet mbi ta duke tadhëtur të gjithë shoket e vet dhe ndihmen e tyre formoi qeverinë e vet. Fillimisht si kryeminister, pastaj si president i Shqipërisë dhe pasatj nga etja e madhe për pushtet u vetëshpall mbret i shqipëtarve pa referendum. Në parlamentin e asaj kohe nga Shkodra ishin tetë deputet, ku nënkryetar ishte Fishta dhe shtatë djem të tjerë, ndër të cilët vetem Musa Juka ishte në mbështetje të Zogut. E para gazetë opozitare në Shqipëri u sponsorizua nga Z. Nush Topalli me të ardhurat e tij personale. Me keto veprime e tradhëtira, jashtë çdo dëshire të shqiptarëve Zogu u vetëshpall mbret, pra u vendos monarkia. U krijua edhe krahu opozitar me në krye Fan Nolin, i cili në programin e tij ndër të tjera paraqiti projekt-reformen agrare, gjë që u perkrah nga Evropa, njëkohsisht Noli u vlersua nga evropianët. Në këtë program gjeti mbështetje të madhe nga Malësia e Madhe, Puka, Dukagjini dhe mirdita. Nga mbështetja që pati Noli mori pushtetin, i cili zgjati vetem


gjashtë muaj. Me ndihmen e Jugosllavisë, Zogu erdhi përsëri në pushtet. Nga këto poshtersi që po bëheshin në kurriz të popullit, shpërthyen kryengritjet popullore të organizuara e të drejtuara nga Ndokë Gjeloşi, i cili për tradhëtinë që u kishte bërë atij dhe shokëve të tij, tentoi t'a vriste në Vien të Austrisë. Ndokë Gjeloşi kishte mbaruar studimet universitare në Itali dhe Akademisë ushtarake në Austri, ky ka qënë komandant i kufirit të veriut në kohën e Princ-Vidit. Megjithëse ishte bërë plani i kryengritjes nga Dukagjini, Malësia e Madhe dhe Puka, por premtimi i Dedë Gjakovës, ish komandant i shtatë batalioneve, deshtoi dhe vetem Dukagjini u çua në kryengritje. Në këtë luftë u plagos Ndokë Gjeloşi, u vra Kolë Binaku nga Dakajt e Shalës, Sadri Deda nga Shoshi, u plagos Nikë Gjoni nga Nicajt. Fatëkeqësisht kryengritja nuk pati rezultat, ndaj Zogu u hakmor ndaj Dukagjinasve në menyra të ndryshme. Mark Sadiku, Ndokë Mirashi i Pepajt, Lush Prela me të dy djemtë nga Pecajt e shumë të tjerë u detyruan të iknin jashtë shteti, ndërsa shumë të tjerë dolën malit drejta doli falja nga ana e mbretit si: Kolë Marku Thethë, Gjergj Pëllumbi, Mark Kola Nderlysa, Gjeloşi Marku Nenmavriq; Babun Celi e Mark Milani, Zef Delia Shosh; e Martin Marashi, Toplanë; nga Puka ishin Gjeloşi Jaku, Ndreke Matiqi, Syk Gjergji. Nga këta u den-

uan me varje në konop: Kolë Marku, Mark Kola, Gjeloşi Marku, Mark Milani, Babun Celi, Zef Delia, Martin Marashi si dhe tre pukjanët e përmendur më lart. Gjeloşi Gjoka i Kastriotit nga lidhja që kishte me mbretin bëri të mundur faljen e Gjergj Pëllumbit Theth dhe Lulash Gjeloşi i Shoshit u fal nderhyrjes së Shuk Serreqit. Mbreti Zog s'ishte gjë tjetër veçse një hakmarrës i pashpirtë, që nuk pranonte asnjë kundërshtar, ndaj organizoi edhe vrasjen e Luigj Gurakuqit, Elez Isufit, Bajram Currit e shumë të tjerëve, që ishin figura të ndritura e patriot të flaktë për fe e Atdhe. Zogu, kur e pa se ishte bërë i padëshirueshëm nga populli i tij, iku nga Shqipëria duke e shitur atë tek të huajt, duke e kthyer vetëveten në një tradhtar të kombit dhe hajdut të paprecedent në asnjë vënd të botës. Thesari i kombit, që u grabit prej rij, kishte 566975 franga ari, kjo vertetohet nga dokumenti i datës 5 prill të vitit 1939. Unë besoj se këto veprime të tij janë të mjaftueshme që ai të mos meritojë asnjë lloj lëvdate nga asnjë shqiptar. Por më habitë fakti që disa parti politike i bëjnë lëvdate vetem e vetem për të rrembyer disa vota mjerane për fushatën që po vjen. Zogu nuk ka qënë kurrë për bashkim kombëtar, por për përçarjen e tij në shërbim të interesave të tij ekonomike. Një njeri që tradhton popullin e tij, që vjellë e shet kombin

duhet të kishte perfundue në det, andej nga iku dhe kurrë nuk duheshin sjellë eshtrat në Atdheun tonë, sepse të vetin e pati shitur me kohë. Sipas të dhënave të thesarit në vitin 1922 në arkën e shtetit kishte 320 ton ar, ndërsa me tradhëtinë e largimin e tij mbeten vetem 90 kg. Ky ka qënë "Mbreti i madh" i shqipëtarve, që i thurin lëvdata, ndekohë që "Ai që e mbron hajninë është më i keq se hajni"- thotë populli. Për të gjitha këto tradhëti, vjellje, servilizma të politikaneve shqiptarë, që po majmen në kurriz të popullit të vet, historia do t'i ndeshkojë e brezat e ardhshëm do t'i mallkojnë. Për çdo politikanë shqiptarë le të hapen dosjet, sepse ky popull ka nevojë për të vërteten e madhe. Le të dalë diagnoza për secilin. Deri kur ky popull do të shkojë duke u mashtruar me lavdërimet dikatorësh vetem për qellime votash. I mirë Fan Noli, i mirë Luigj Gurakuqi, i mirë Bajram Curri 'i mirë' Ahmet Zogu! Si ka mundësi të jetë i mirë ai që ka vlarë të mirë të një kombi siç bëri Zogu dhe Enveri!? Do të ishte fatmirësi sikur politikanët tanë a gjejnë sadopak vtëveten, të vlersojnë ata që duhet e këtij populli mos t' serviren më figura gjakatare si Ahmet Zogu e Enver Hoxha.

DEDE TOKA

RRETH EMRAVE VETJAKË DHE MBIEMRAVE, SHALË - 1990



Nga LUIGJ SHYTI

Studimi i emrave dhe mbiemrave forcon ndjenjën e identitetit të një familje, të një zone, të një nacionaliteti. Sa më shumë shtrihet çështja e globalizimit aq më shumë shtohet dëshira për identitet.

Antroponimia është ajo degë e shkencës që merret me studimin e emrave vetjakë të njerëzve, përbërjen e tyre, formën e krijimit, etimologjinë, strukturën dhe veçoritë fonetike. "Emrat e njerëzve dhe emrat e vendeve përbëjnë dy rrathë të një sistemi tërësor, të sistemit të emrave të përvetshëm të shqipërisë", shkruan J. Shpuza.

Është një gjë e bukur të njohësh dhe të merresh me emrat apo mbiemrat e familjes, lagjes, fshatit apo edhe më gjerë. Aty shikohet jetë, gjallëri, trashëgimi, kulturë, histori, besim, e te tjera.

Puna për studimin e emrave vetjakë dhe mbiemrave të banorëve të zonës së Shalës u mendua që ta bënim sipas familjeve në vitin 1990, pasi mendojmë se është koha kur zona e Shalës ishte në kulmin e popullimit të saj. Do të donim që në studim të përfshiheshin të gjithë banorët sipas regjistrimit në zyrën e gjendjes civile, por nuk e patëm mundësinë. Atëherë u morëm me emrat e kryefamiljarëve, me emrat e të zonjave të shtëpive në disa fshatra duke e menduar se mund të ishin përfaqësues dhe mund të tregonin shumëçka, për trashëgiminë, toponimet, gjenezën, historinë, besimin, si dhe me mbiemrat e tyre. Unë dua të falënderoj shokët e mijë Fran Çardaku, Zef Lulashi, Ndue Vata, Prelë Shytani, Kin Nika, Fran Stani e Fran Beka, të cilët mundësuan evidentimin e familjeve që banonin në këtë zonë në vitin 1990. Këto regjistrime janë një tregues mjaft i mirë i realitetit për kohën kur bëhet fjalë.

U evidentuan 959 kryefamiljarë të cilët banonin në Shalë në vitin 1990, si dhe regjistrimi i të zonjave të shtëpisë në Theth, Lotaj e Pecaj. Nga ky studim dalin të dhëna me shumë vlerë për sot por shumë më tepër sa më shumë kohë të kalojë.

Çështja e emrave vetjakë është me rëndësi sepse tregon në përgjithësi rrjedhën e familjes, vëllazërisë e më gjerë, sepse tashmë dihet, se njerëzit, e veçanërisht në zonën tonë kanë pasur parasysh që emrat të përsëriten nga brezi në brez për të mos u haruar prejardhja. Kemi raste shumë që emrat kanë një hallkë zinxhiri që përsëritet pas dy-tre brezash. Kjo përforcon mendimin se kur analizon emrat, fjala vjen të kryefamiljarëve, mund të marrësh një informacion mjaft të rëndësishëm në lidhje me llojshmërinë, qëndrueshmërinë dhe përhapjen e një vëllazërie, të një fisi apo të një gjaku. Kjo, pa tjetër që ndikon edhe në evidentimin e fizionomisë dhe ndjenjës kombëtare.

Në gjysmën e dytë të shekullit të kaluar, si kudo, edhe në zonën e Shalës, hynë edhe emra të rinj në përdorim. Kjo erdhi nga që nga njëra anë filloj një luftë e rreptë, kundër besimit fetar dhe për pasojë "rekomando-heshin" emra jo fetar që pati një ndikim jo të lehtë, por nuk arritën të zhduknin ndjenjën për të pasur emra të tillë, e as besimin fetar. Nga ana tjetër dëshira për modernizimin edhe në emrat e përdorur për tua vënë fëmijëve, me hyrjen e televizorit aq sa mund të shikohet, duke parë filma, duke ndjekur sportin, dukë lexuar libra, e duke u ndikuar prej tyre sollën një llojshmëri të re në emërtimet vetjake. Vullshëm u përdorën emra nën ndikimin e hapjes ndaj botës që ndoli pas vitit 1990, sa mund të thuhet se jemi përfshirë rrëmbyeshëm në vendosjen e emrave nën ndikimin e jashtëm, ndoshta, edhe duke dashur të ndryshojnë traditën e vjetër. Të tillë emra mund të përmendim Klisman, Rrezearta, Jetmira, Vladimir, Dritan, Luçian, Valentin, Valentina, Genti, Luanesha, Arbër, Arbën, Ilir, Teuta, Eduard, Edmond, Fatmir, Fatmira, Flora, Florian, Gojard, Drita, Kujtim, Albert, Alban, Agim, Suela, Artur, Migena, Leonard, Luan, Paulin, Gëzim, Liri, Lindita, Vera, Izabela, Maldin, Françesk, etj. Duhet thënë se kjo hapje e vullshme ndaj emrave të kombeve të tjera tregon "shkallën e lartë të emancipimit të shoqërisë shqiptare, por edhe shkallën e ultë të ndërgjegjes kombëtare të tyre", do të shkruante studiuesi Jusuf Shpuza. Por nga ana tjetër gjithnjë e më pak po duken emra si Tahir, Murrikë, Zhuj, Koliq, Zhujë, Vocërr, Cul, Qerim, Shkurte, Sose, Coc, Kamber, Macë, Galë, Trashe, e te tjere.

Vihet re një lidhje e rëndësishme midis nivelit kulturor të prindërve apo familjes edhe në gjetjen e vendosjen e emrave të fëmijëve të tyre, por është edhe ngritje e nivelit të zhvillimit të shoqërisë, të kulturës dhe të mendimit të njerëzve në tërësi. Natyrisht emrat vetjakë janë më të pa qëndrueshëm në krahasim me emrat e vendeve apo të familjeve të cilat i rezistojnë më shumë kohës, por mendojmë se për disa zona, siç është edhe zona e Shalës, të cilat kanë qenë mjaft të izoluara nga kushtet shoqërore dhe natyrore për një kohë të gjatë, emrat vetjakë tregojnë në vija të përgjithshme prejardhjen dhe qëndrueshmërinë e emrave vetjakë, dhe rendjen e tyre nëpër shekuj.

Në të kaluarën, banorët e këtyre anëve, me gjithë izolimin dhe kushtet e terrenit dhe mungesën e mjeteve të komunikimit janë përpjekur për të gjetur emra që i pëlqenin më shumë, që ishin disi vijues të të parëve dhe që i përshtateshin besimit fetar të tyre si, Ndue, Prendë, Zojë, Kolë, Shtjefën, Gjon, Pashkë, Gjergj, Mari, Mark, por edhe emra me prejardhje pagane, si Bjeshkë, Diellë, Balë, Bardh, Bardhë, Borë, Lulë, Lulash, Dash, Hanë, Mic, Macë, Shkurtë, Shpënd, etj. Në ndikimin e pushtuesve u vendosën edhe emra me ndikim të besimit mysliman si Tahir, Hysen, Hasë, Mehmet, Hajdar, Demë, etj.

Duke u përpjekur për të përballuar vështirësitë e kushteve dhe të komunikimit është pasur parasysh që emrat të jenë sa më të "zëshëm" me qëllim që të kenë mundësi për të thirrur, për të komunikuar në distancë pa shumë zor, si Kolë, Lulë, Prelë, Ndoc, Prëndë, Gjëlosh, Mirash, Gjergj, Mark, Tringë, Bute, Bjeshkë, Zef, Diellë, Mari, e te tjere.

Siç do ta shikojmë edhe në vijim, në të shumtën e rasteve kemi emra me dy rrokje dhe më pak me një rrokje, apo me tre rrokje dhe krejt pak ose aspak me më shumë rrokje. Ata nuk e kanë ditur se çfarë është rrokja,

por e kanë gjetur atë emër që u mbushte më shumë gojën dhe mund të thirrej më lehtë në largësi.

Emrat vetjakë marrin rëndësi edhe më shumë pasi ata lidhen shumë edhe me toponimet e territoreve ku punojnë e jetojnë, ku kane pasur pronat e tyre, ku janë aksidentuar, ku kanë vdekur, pra në një masë të konsiderueshme tregojnë rrjedhën e jetës, e këto toponime trashëgohen shumë gjatë.

Le të ndjekim disa karakteristika të llojshmërisë së emrave të zonjave të shtëpisë në zonën e Shalës, të cilën e kemi marrë në studim. U ndalën në tri fshatra që mendojmë se është e mundur që të jemi më afër realitetit.

Nga 325 gra të përfshira në studim, emrat e grave më të përhapur janë, Lulë 10.6 %, Prendë 8 %, Pashkë 6.6 %, Mari 5.9 %, Age 5.9 %, Lenë 5.9 %, Katrinë 5.6 %, Mri 5.6 %, e deri te Dikë, Macë, Trashe, Shuke, Zhujë, etj me 0.3 % secila. Në këtë territor ka 47 lloje emrash të zonjave të shtëpisë ose gati 7 % zonja shtëpie kanë të njëjtin emër.

Nga analiza del se 5.7 % e grave kanë emrin me një rrokje, 83 % dy rrokjesh, 11 % tri rrokjesh dhe vetëm 0.3 % ka mbi tre rrokje.

Emrat vetjakë të kryefamiljarëve të zonës së Shalës janë interesantë dhe të bukur. Këtu kemi pasur më shumë përqendrim sepse donim që të kishim sa më shumë mbiemrat e tyre dhe për të parë llojshmërinë dhe përhapjen e tyre.

Emrat e kryefamiljarëve më të përhapur në këtë zonë janë, Kolë 7.5 %, Mark 6.5 %, Zef 6.0 %, Ndue 5.8 %, Dedë 5.4 %, Pjetër 4,5 %, Mhill 4.3, Gjon 4,1 %, etj. Në zonën e Shalës në vitin 1990 ka 84 lloje emrash të kryefamiljarëve. 11.4 % kryefamiljarë kanë emër të njëjtë, ndërsa sipas fshatrave kemi mesatarisht këtë numër të njëjtë emrash të kryefamiljarëve: Theth 4.8 %, Gimaj 4.8 %, Nënnavriq 2.7 %, Vuksanaj 2.7 %, Lekaj 2.6 %, Lotaj 2.3 %, Nicaj-Shalë 2.3 %, Abati 2.2 %, e Pecaj 1.5 %.

Nga shikimi i gjatësisë së emrave në rrokje dalin se 38 % e tyre janë emra me një rrokje, 58 % janë me dy rrokje, 4 % janë me tri rrokje dhe nuk gjejmë asnjë mbi tri rrokje.

Shumë interesantë është lista e mbiemrave që ekzistojnë në zonën e Shalës në vitin 1990. Në të kaluarën, për mbiemër banorët në këto anë mbanin emrin e babës dhe më pak të gjyshit dhe asnjëherë nuk kishte mbiemra si dallues i një familjeje nga një tjetër. Na atë kohë përdorej emri i shtëpisë ose vllazërisë apo fisi, ky mund të quhet si një mbiemër, p.sh. "ky është i shtëpisë së Lul Gjokës", "është i shtëpisë së Shytan Prekës", "është i Pecaj", "është i Vaçaj", "është i Kolmarkaj", "është Thethjanë", "është i Gimaj", "është i Babçuer", "është i Dragaj", e te tjere.

Pas çlirimit u bënë regjistrimet e popullsisë në këtë zonë duke shënuar edhe mbiemrin për çdo familje. Duke menduar, se me marrjen e një mbiemri nga një vend, një arë, një bjeshkë, një mal, një krahinë, etj, do të ruhej me gjatë, do të fliste më shumë, e në ndonjë rast mendohej se mund të krijohet mundësia e mëvonshme për të bërë të mundur pronësimin e kësaj pjesë ose të paktën pasardhësit mund të mendonin se dikur ka qenë pjesë e tyre sepse edhe mbiemri "lidhet" me të.

Është edhe një problem tjetër. Në kohën që filluan regjistrimet nëpër zyrat e gjendjes civile të kohës është vërejtur një fenomen që ka çuar në shtimin e llojshmërisë së mbiemrave. Kjo, mbase ishte një farë dëshire, ose "dëshirë", për t'u ndarë nga e kaluara, sepse kishte filluar edhe lufta e klasave e ku për nën zë e ku edhe hapur "rekomandohej" regjistri-

mi i mbiemrit ndryshe nga të tjerët, ose edhe për të shkëputur familjet e mëdha dhe për të krijuar degë të reja me mbiemra të ndryshëm dhe për të formuar trungun e vet. Kjo ishte edhe si pasojë e mungesës së përvojës për ruajtjen dhe trashëgiminë e mbiemrit për të gjithë familjet e një grupi të afërt me gjak nga linja e babës.

Mbiemrat kanë ardhur duke u ndryshuar vazhdimisht, por jo me atë vullmin e fillimit. Ka pasur raste që është formësuar mbiemri i një familjeje pa pasur asnjë kuptim dhe ndoshta vetëm se është bërë gabim nga një transferim në regjistrat e gjendjes civile në momentet e ndarjes së familjes dhe kështu i ka mbetur. Le te përmendim një shembull konkret të pasaktësisë së transferimeve të mbiemrave. Familja Drëni ndahet në Theth dhe formohen dy familje të tjera. Njëri i mbetet mbiemri normal dhe tjetri i vendoset mbiemri "Noheni", mbiemër ky pa asnjë lidhje dhe pa asnjë kuptim për familjen dhe fshatin. Kemi një rast tjetër, po në Theth, që është interesant, por mbiemri i përfituar është shumë i bukur, "Kometa". Ky mbiemër ka ardhur si rezultat i prone që quhet "te ka mbete Meta" që është transferuar në mënyrë të pavetëdijshëm nga punonjësit e gjendjes civile "Kometa", fenomen kozmik që për kohën kur bëhet fjalë nuk ishte i njohur ndër malet tona dhe e shumta njihej si "Ylli me Bisht".

Me kalimin e kohës, me shuarjen fizike të familjeve janë zhdukur edhe mbiemra e tyre. Në Theth nuk janë më në përdorim mbiemrat "Sicça", "Pojata", "Ara", "Gryka", "Sogja", "Vata", "Rasa", "Ograja", e te tjere.

Është për tu lavdëruar mbajtja, pothuaj nga të gjithë emigrantët, e mbiemrave me të cilin u larguan kudo që janë përhapur nëpër botë. Kjo është shenjë e dashurisë për vendlindjen, është patriotizëm, është vlerësim e vazhdim i trungut familjar, është vlerësim i historisë.

Në vitin 1990 kemi në zonën e Shalës 344 lloje mbiemrash, ndërsa sipas fshatrave kemi këtë shpërndarje, Thethi 110 lloje mbiemrash, Gimaj 84, Nënnavriq 27, Lotaj 29, Vuksanaj 15, Nicaj Shalë 18, Pecaj 16, Abat 25, dhe Lekaj 51 lloje. Mesatarisht kemi këtë shpërndarje të mbiemrave. Thethi mesatarisht 2 familje kanë të njëjtin mbiemër, Gimajt 2.3, Nënnavriq 3.5, Lotaj 3.0, Vuksanaj 5.3, Nicaj Shalë 4.4, Pecaj 2.1, Abat 3.0 dhe Lekaj 1.6. Duket se disa fshatra kanë mbajtur më shumë afërsi me trungun familjar dhe disa të tjerë kanë pasur një tendencë shkëputje. Si zonë kemi një mesatare prej 2.8 familje që kanë mbiemër të njëjtë.

Mbiemrat më të përhapur në zonën e Shalës janë: Nika 23 familje, Marku 20, Sokoli 19, Delia 19, Koçqea 15, Stenaj 14, Fusha 13, Shelnishta 13, Shytani 12, Ndreza 11, Vata 11, Bregu 11, Çuni 11, Logu 10, Hasanaj 10, Vuksanaj 10, Pjollë 10, e te tjere.

Në këtë zonë 86 kryefamiljarë kanë mbiemra të cilët nuk përsëriten te kryefamiljarët e tjerë.

Vihet re prania e 84 lloje emrash dhe 344 lloje mbiemrash në zonën e Shalës, dhe del se ka 4.1 herë më shumë lloje mbiemrash se lloje emrash në këtë zonë.

Me interes është studimi i origjinës së mbiemrave të banorëve të kësaj zonë. Nga një sistemim i tyre në mënyrën më të mundshme kemi, mbiemra që kanë lidhje me emra të trungut familjar 43.8 %, nga emërtime pronash dhe vendesh 32.6 %, nga emërtime drurësh të ndryshëm 7.4 %, nga emërtime objektsh natyrore 12.0 %, nga emërtime objektsh të veprimtarisë së njeriut 2.3 %, nga emërtime shfaqje kozmike 0.3 %, nga emërtime shfaqje atmosferike 0.2 % dhe nga emërtime pa ndonjë kuptim 1.4 %.

Ajo që bie në sy më shumë është qëndrueshmëria e mbiemrave me prejardhje nga emrat e trungut familjar dhe pas kësaj rresh-tohen mbiemrat në lidhje me toponime të ndryshme të zonës.

ÇATIN SARAÇI PER AHMET ZOGUN: "VRASES DHE HAJDUT!"

Kujtimet e diplomatit dhe ish mikut të ngushtë të Zogut, Çatin Saraçi, për vite të tera ishte pranë tij. E përshkruan si njeri brenda të cilit triumfoi përfundimisht e liga. Kurthet, intrigat, vrasjet, përfitimet e frikshme në rryshfete të padëgjura dhe shitja e një vendi, në rrëfimin e rrallë të Saraçi:

Ahmet Zogu, i kurorëzuar me vone mbret i Shqipërisë me lejen e Musolinis, lindi rreth vitit 1893. Asokohe Shqipëria ishte province turke dhe turqit nuk e kishin me detyrim regjistrimin e lindjeve në asnjë vis të perandorisë. Ndërkohë që të krishterët shqiptarë regjistroheshin në librin e kishës, krahina e Zogut nuk e njihje këtë lloj regjistrimi sepse ishte kthyer në blok në fenë muhamedane në vitin 1851. Kur mbushi tete vjeç, Zogu u dërgua në Kostandinopoje ku kreu shkollën fillore dhe mësoi turqisht në mejtepe. Gjate gjithë jetës së tij, Zogu ka kryer vetëm këto tri klase shkolle: Nga Shqipëria kishte marre me vete një tutor, Abdurrahman Krosi (Lale Krosi), njeri krejt analfabet, bëmat dhe krimet e të cilit nuk lënë pa prekur as njerëzit e familjes (dihet se cyti vrasësit e të vëllait). Saraçi saktëson se ngaqë nuk e mësoi kurrë gramatikën e shqipes, Zogu nuk ia ka shkruar kurrë njeriu asnjë letër me dorën e vet, por i ka diktuar ato.

Në vitin 1917, kur ndodhej në Vjene me studime pas një burse të qeverise austriake, ndodhi dhe takimi i pare i Çatinit me Ahmetin. Atëherë Austria ndihmonte në arsimim një grusht shqiptarësh të spikatur, pasi kishte plane për këtë vend të vogël. Ndërsa mbi dy të tretat e Shqipërisë ndodheshin nën pushtimin austriak, 70 kryetare fisesh u nisën në Vjene t'i paraqesin nderimet Kajzerit, mes tyre dhe Zogu. "Me lanë përshtypje të thelle fjalët patriotike që dilnin nga goja e një muhamedani shqiptar", thotë për Zogun Saraçi. Takimi i dyte tre vjet me vone në Tiranë, e bindi Saraçin se një njeri me entuziazëm të tillë i duhej Shqipërisë, ndaj "u betova ta ndihmoj me mish e me shpirt". Dhe viti 1920 e gjen Shqipërinë me këtë pasqyre politike: Klasa sunduese ishin bejlerët, ndërsa Zogu ishte në opozite, i përkrahur nga rinia.

"Ai ishte tipi ideal për udhëheqje, po të kemi parasysh se asnjë katolik nuk mund ta reformonte vendin pa shkaktuar një konflikt serioz fetar". Saraçi vuri re se si kryeministër, Zogu mori disa reforma drastike duke tronditur keqas doket kanceroze aziatike: I ktheu varrezat muhamedane në parqe, u dha mundësinë grave myslimane të merrnin iniciativën në duar, ndaloi me ligj poligaminë, fete nuk duhej të përziheshin në punët e shtetit. "Atëherë vendosa të predikoja për të në zonën e Shkodrës, ku Zogu njihesh shumë pak", thotë Saraçi, duke shtuar se qyteti i tij i lindjes ishte de fakto kryeqytet për Shqipërinë e vogël. Por këtu mbarojnë përshtypjet e tij të mira për Ahmetin, i cili të vetmen histori që kishte mësuar edhe në detajet më të hollësishme, ishte ajo e Napolon Bonapartit.

Ja si e përshkruan Saraçi situatën e nxehte të viteve 1922-1924, e papërsëritshme në historinë shqiptare qofte dhe për faktin se mes vrasjesh e betejash politike, mori jete foshnja e parlamentarizmit shqiptar: Shefqet bej Verlaci ishte kryetari i shtetit skeletik shqiptar. Çifligari me i madh i vendit me mbi 40 mijë ha toke të punueshme në Shqipërinë e jugut pa llogaritur sipërfaqet e shitura, ai kishte gjithmonë njerëz të gatshëm për ta ndjekur. Zogut i duhej kjo force, ndaj në 1923-shin fejojete me vajzën e Verlacit. Pas kësaj, ky i fundit i jep gjithë votat e përkrahësve në parlament dhe stabilizon situatën e dobët financiare të dhëndrit duke i paguar rreth 18 mijë paunde (Saraçi flet gjithmonë me monedhën britanike). Një vit me vonë, Zogu kryeministër plagoset nga Beqir Valteri dhe si i pamundur për disa jave, ia de-

legon pushtetin vjehrrit. Ndërkaq, thur planin me ndihmën e përhershme të Lale Krosit dhe kryen shpagimin e gjakut duke vrare Avni Rustemin, pa llogaritur ndoshta se me këtë do të ndizte revolucionin. I lutet vjehrrit ta ndihmojë në konflikt me të holla e njerëz, por Shefqet beu që nuhat rrezikshmërinë e situatës, rreket për kompromis me kryengritësit nga frika e humbjes së pasurisë. "Atëherë ne morëm rrugët dhe u larguam, ndërsa kur Zogu hyri pas gjashtë muajsh triumfator në Tiranë, e la mënjanë Vërlacin, duke ia kthyer edhe 10 mijë paundet e dhëna nga ish vjehri pas fejesës".

Sa për përgatitjet e rikthimit, përveç faktit të njohur se Ahmet Zogu u ndihmua nga kryeministri serb Pashiç me të holla (250 mijë paunde) e njerëz, duke i falur në këmbim Jugosllavisë kullotat e pasura të Vermoshtit dhe Shën Naumin, Saraçi nënvizon se ajka e ushtrisë së "Le-



Ahmet Zogolli dhe Çatin Saraçi organizatorët e vrasjes së Luigj Gurakuqit

galletit" ishin rreth 500 oficerë bjelloruse nga mbeturinat e Vrangelit që u thyen nga Ushtria e Kuqe, eksperte në luftimet frontale dhe në armët automatike. Këta udhëhiqnin rreth 5 mijë shqiptarë të Kosovës, të cilët marshuan drejt një kundërshtari po aq të forte, por të pajisur keq. Dinakëria e Zogut inicioi edhe një lëvizje mashtruese për qeverinë e Fan Nolit. Ai bashke me shpurën e vet, bene një udhëtim çoroditës nga Beogradi në Vjene e në Prage, për të dhënë idenë e ikjes. Në Vjene gjeti dhe bukuroshe Franci, e cila për ca kohe me pas, jetoi si mantenuete në Tiranë, ku pat ardhur me dy valixhe të vogla dhe u largua me dy kamionë plot baule të reja dhe një dore të mirë parash.

Hapat e pare të Ahmet Zogut pas fitores? "Shpallja e vetes president e më pas mbret me bekimin e Italisë, eliminimi sistematik i armiqve politike dhe marrja e masave për t'u rrethuar gjithmonë e me tepër nga një bande njerëzish injorante e analfabete që e lëvdonin ore e çast, kryenin çdo porosi dhe vidhnin pa pushim shtetin". Të cilët përshkruhen kështu nga Zogu në një rrëfim intim: "Ky është cirku im. Ajo çfarë ata dine ose ndjejnë nuk më intereson hiç fare. Për aq kohe sa i nënshtrohen kamxhikut tim dhe nuk hedhin vickla, unë jam i kënaqur me ta dhe i mbaj".

Megjithatë, me Saraçin dhe Jak Koçin, Ahmet Zogu do të ruante një marrëdhënie të veçantë. E kërkonte mendimin dhe këshillën e tyre, paçka se shume here dëgjonte prej tyre kritika. Por sipas Saraçit, dy ishin synimet e tij të fshehta dhe finale: Të pasurohej sa me shpejt dhe sa me shume, dhe të shtypte e poshtëronte çdo atdhetar e patriot me mjetet e pushtetit. Nga ana tjetër, Zogu nuk hezitoi aspak ta vinte vendin nën zgjedhën e ekonomike italiane me Traktatin e pare të Tiranës, me dekretin për krijimin e Bankës Kombëtare të Shqipërisë me kapital italian (duke ia nënshtuar fqinjët të madh gjithë jetën ekonomike e financiare në vendit), me firmosje te borxhit prej 50 milionë franga ari në këmbim të ndërtimit nga italianet të porteve e rrugëve strategjike që do përgatishnin pushtimin e Shqipërisë po prej tyre, me Traktatin e dyte të Tiranës e te tjera.

Dhe vijojnë dëshmitë tronditëse të Çatin Saraçi: Ahmet Zogu jo vetëm që ka marre mite (ryshfet), por në çdo rast ishte ai vete që përcaktonte sasinë që i duhej. I pajisur me pasaporte diplomatike dhe dokumente extra, tutori

i moshuar i Zogut largohej nga vendi me kamionë të ngarkuar me valute, i shoqëruar nga roje të armatosura. Këto udhëtime kryheshin rregullisht kurdoherë që Zogu kishte hedhur nënshkrimin mbi ndonjë akt të ri, ndërsa itinerari i rëndomtë ishte: Durrës-Bari, e prej andej në Gjeneve të Zvicrës. Sapo paratë siguroheshin në një banke të huaj, përcillej urdhër me shkrim që të transferoheshin në një vend edhe më të sigurtë se i pari. "Për rrjedhoje, pjesa me e madhe e këtyre parave gjendet në Lloyd's Bankë të Londrës. Unë vete me dorën time, kam shkruar një sere urdhrash të kësaj natyre si dhe i kam ardhur në ndihme tutorit analfabet për të mbërritur në kufi në Zvicrën", shkruan Çatin Saraçi. I cili shton se si tutori Lale Krosi, edhe Zogu, i kishin thënë se në ato kamionë ndodheshin dokumente shtetërore me rendësi jetike, "çka unë fillimisht e besoja".

Dhe paratë shtese përfitoheshin në njëmijë mënyra, përveç rrogës zyrtare prej 35 mijë paundesh në vit. një shembull: Rrogat e 5 mijë mercenareve që e sollën në pushtet, vileshtin rregullisht në çdo fund muaji nga Zogu, pavarësisht se ata ishin larguar shume herët nga Shqipëria. një tjetër shembull i paskrupulltësisë: Zogu-Saraçi, "Çatin, ne jemi vend bujqësor pa këmbë kapitalist, ndaj e kam fjalën të hapim negociatën me sovjetiket dhe t'ua përmbushim kërkesat që nuk arriten të realizojnë përmes Fan Nolit.

Por me një kusht: Sovjetiket të me paguajnë në dorë 300 mijë paunde..." Saraçi nuk e kreu kurrë një negociatë të tillë, por Zogu kish nevojë për para. Trilloi një histori sikur prijësit e Veriut po rebeloheshin se nuk qenë paguar për ndihmën që i dhanë dhe kërkoi nga italianet 200 mijë paund. Por dhe kur i mori paratë, nuk shpërndau asnjë kacidhe.

Shembulli i fundit për sa u përket parave, sepse të tilla Saraçi ka shume, vjen pas krijimit nga italianet të Bankës sonë Kombëtare. Myfit bej Lobohova "gjysme çerkez e gjysme shqiptar", ishte në atë kohe i falimentuar, dhe dihej nga të gjithë se ky ministër Financash kishte lënë peng gjithë pasurinë për 80 mijë luigje ari. "Mbasit statuti i Bankës u miratua, Myfiti jo vetëm që lau gjithë borxhet e veta, por i tepruan para edhe për të blere një alamet pallati në Rome dhe nisi të japë para me interes". Dhe kur Saraçi merr vesh në Rome se Zogu për këtë rast special kishte përfituar 5 milionë franga ari, nisat për Tiranë ku pas një bisede të gjate me Zogun, dëgjon nga ky i fundit se kishte marre vetëm dy milionë?!

Një pjese të veçante Saraçi i kushton në dorëshkrimet e veta, eliminimit që Zogu u beri kundërshtarëve të vet. Vrasja e Luigj Gurakuqit në vitin 1925 në Bari të Italisë nga djali i tezes (Balto Stambolla, emrin Saraçi nuk e përmend) i paguar nga Zogu, ndodhi kur vete Çatini ishte në Bari, ku sapo kishte marre detyrën e konsullit. Shume zëra ia atribuojnë organizimin e vrasjes vete Çatinit, por ja çfarë thotë ai: "Ironia është se vrasësi, një dite me pare me takoi në zyrën time duke me thënë se kishte ardhur për të kryer një vepër të madhe patriotike. E njihja mire që nga koha e shkollës, që një aventurier e burracak i pashoq, prandaj dhe nuk e mora mundimin ta lajmëroja udhëheqësin e opozitës, me të cilin vijoja ta mbaja ende marrëdhënie të mira personale. një vit me pare kisha mundur t'i shpëtoja jetën viktimës po në Bari, ndaj ai vete dhe familja me patën shprehur mirënjohjen. Asokohe mendoja se vete Zogu nuk ishte i lidhur direkt me këto gjema". Pas eliminimit të Gurakuqit, Saraçi nisat urgjent për në Tiranë, ku gjen Zogun dhe kunatin e tij Ceno Beg Kryeziun (me serb nga vete serbet) shend e vere. Historia vazhdon me vrasjen e Bajram Currit po nga trupat e Ceno Begut, në fakt ushtarë serbe të maskuar. Sa i përket Zogut, Saraçi thekson se që kur Bacë Ba-

jrami mori malet me 500 vete, Ahmeti e dinte se nuk kishte ç' të bënte sado ushtarë të niste, ndaj vendosi ta linte në fatin e vet. Por misionin do ta përmbushte kunati Ceno Beg atëherë ministër i Brendshëm, "ndoshta", thekson Saraçi, "si pjese e marrëveshjes që ishte bere me Pashiçin për të vrare luftëtarët e Kosovës". Ironikisht, Ceno Begu e pa me sy shume të keq afrimin e Zogut me Italinë, sepse atij po i minohej misioni projugosllav. një oficer shqiptar i rrëfen Saraçit se Ceno ishte shprehur në rreth të ngushte për "tradhtinë e Zogut ndaj miqve që e ndihmuan". Çatini ia shtie në vesh Ahmetit dhe pas kësaj Ceno Begu ballafaqohet koke me koke me Zogun. Rezultati: Ftohja përfundimtare, aq sa Ceno filloi të ruhej me roje të armatosur nga frika e kunatit. Më pas largohet nga Shqipëria drejt Pragës si ambasador, por me 14 tetor 1927 qëllohet për vdekje në kafe Passage nga studenti shqiptar 23 vjeç, i quajtur Alqiviadh Bebi prej Elbasani. Vrasësi nuk tregoi asgjë, por Çatini vjen nga Vjena në Prage për të asistuar bash në deklaratën e vëllait të Cenos, Gani beg Kryeziu, që sapo kishte ardhur nga Beogradi, para kufomës se byazerit: "Zogu ka për ta paguar këtë një dite".

Çatin Saraçi flet për shume çështje të errëta apo të ditura të jetës së Zogut. Flet dhe për personazhin enigmatik Jak Koci, "një nga mendjet me të zhdërvjellëta të vendit tone, ndonëse makiavelist e ndjekës fanatik". Treshja Zogu-Koci-Saraçi kishin rene dakord për punët e tyre të ardhshme t'i ndanin fitimet 20%-Jaku, 10%-Çatini dhe pjesa tjetër, Ahmeti. Por Zogu gjithmonë i fshihte përfitimet për të mos u lënë pjese dy aventuriereve të tjerë, çka inicioi edhe një sherr mes Jakut dhe Zogut. Sa për martesën e famshme të Ahmet Zogut, ajo nisi si dëshirë për t'u martuar me bijën e mbretit Viktor Emanueli III, kërkesë që i gajasi hierarket e larte fashiste dhe mikun e ngushte të Saraçit, nënsekretarin fashist për Kolonitë Alessandro Lessona, një mik i ngushte i Musolinis. Ky i fundit i raporton Duçes se "maloku analfabet na dashka nuse të larte", vijon një refuzim dëshpërues për Zogun, pastaj kohe me vone nisin tratativat që bitisen me princeshën hungareze Aponny.

Libri që përftohet prej shkrimeve të Çatin Saraçit, është i papërfunduar ndërsa shënimet e fundit duhet të jene aty rreth vitit 1940. Në fakt, disa prej temave që ai nuk i shtjelloi dot, janë tejet intriguese: Zogu si oficer austriak, Zogu i internuar në Vjene, Vrasja e Esat pashës, Vrasja e Avni Rustemit, Gjithë Shqipëria kundër Zogut, Zogu merr 250 mijë sterlina për grushtin e shtetit, Veprat kriminale të motrave të Zogut, Lessona na dorëzon 5 milionë lira të mbyllura në valixhe, Mita e dyte prej 10 milionë frangash ari, Revolta e pare kundër Zogut, Vrasja e Hasan Prishtinës, Kriza e parë nervore e Zogut e te tjerë e te tjerë për Aurel Plasarin, autorin e parathënies se librit, është për të ardhur keq që këto çështje nuk u shtjelluan. Por konkluzioni i këtij libri, paçka se të pambaruar, është i vete Saraçit: Mustafa Qemali, ishte shqiptari që shpëtoi kombin turk, ashtu si Ahmet Zogu, një mendësi anadollake që shkatërroi Shqipërinë.

"Unë Çatin Saraçi, të akuzoj ty Ahmet Zogu si tradhtar të atdheut tënd, si vrasës e hajdut. Shqipëria ka pare pushtues edhe me të fuqishëm se këta të sotmit. Do të ikin edhe këta, por emri yt s'ka për të figuruar gjëkundi. Synimi i kësaj letre është te të paralajmëroje për here të fundit të mos ngatërrohesh më me Shqipërinë, ndryshe do të detyrohesh t'u tregoj diçka me shume francezeve dhe anglezeve. Bankënotat false që më dhe si dhe letrat e tua të fundit, po i ruaj si dokument i pandershmërisë sate..."

Çatin Paskal Saraçi, London, 21 A.S tratford Rd."

Pergatitur nga Alqi Kociko

Kur mungon dashuria e nënës

Për ata që nuk i dinë pasojat e mungesës së dashurisë së nënës tek femija, që nga momenti i lindjes, është shumë e vështirë që ti imagjinojnë ato. Femija, që nga momenti që shkeputet nga barku i nënës, pushtohet nga ndjenja e frikës dhe e pasigurisë. Askujt tjetër nuk mund tja besojë ai sigurinë e tij veçse nënës së vet. Nevojat themelore të tij janë kontakti trupor, perkushtimi shpirtëror, ndjenja e mirëseardhjes dhe e sigurisë. Këto perbejnë bazamentin mbi të cilin femija do të ndërtojë personalitetin e tij të arthshëm. Veçanërisht vitin e parë të jetës së tij femija është shumë i lidhur me nënën dhe shumë i influencuar nga dashuria e saj. Ata që nuk e perjetojnë këtë në këtë fazë, do të vuajnë gjithë jetën. Femija bebe, kur shikon shkelqimin e syve të nënës, ndjehet i sigurtë, i lumtur dhe i qetë.

Psikologjia e zhvillimit percakton etapat në të cilat kalon një zhvillim psikik i shëndosh tek njeriu. Djegia ose kapercimi i tyre, shkaktojnë tek personaliteti i arthshëm i individit pasoja nga më të ndryshmet. Dhe këto etapa fillojnë që nga momenti i shkeputjes së femijës nga barku i nënës. Në këtë fazë, femija duhet ta ndjejë veten, ashtu si më parë në barkun e nënës, një person me nënën. Në kulturën e rritjes së femijëve të disa popujve, nënat i mbajnë bebet në kurriz, kështu që qumështthithësi e ndjen veten një trup me nënën. E shprehur kjo në

gjuhën profesionale, quhet simbiozë (dy gjallesa në një trup). Pashkëputshmëria fizike e bebit nga nëna është siguria më e madhe jetike për atë. Për zhvillimin fizik të femijës duhen ushqim, ngrohtësi dhe higjienë. Për zhvillimin shpirtëror i duhen dashamirësi dhe kontakt lëkurorë (fizik) nëpermjet ferkimeve. Ai don që ta ndjejë, nuhasë dhe shijojë nënën e vet. Fillimisht femija është në gjendje vetëm sa të mund të bëjë dallimin midis kënaqësisë dhe pakënaqësisë. Kënaqësinë ai e merr nepermjet të thithurit të gjirit të nënës dhe perkëdheljeve të saj. Pakënaqësinë ai e ndjen nga ndjenja e urisë, dhimbjet dhe ndjenja e braktisjes nga nëna apo personat e tjerë që mund ta shoqërojnë atë. Në raste të tilla, shumë bebe reagojnë në mënyrë agresive, me qarje të forta deri në nxirje të fytyrës dhe trupit. Gradualisht, femija duke u rritur, fillon shkeputjen fizike nga nëna por, jo nga prania e asaj. Sidomos kur ndjehet i frikësuar kthhet menjherë tek ajo. Nëna duhet që vazhdimisht ti japë atij sigurinë se i ndodhet pranë, me qëllim që femija të shtojë distancën e rrugës të eksploruarit. Kështu femija ndjehet i sigurtë dhe vihet vazhdimisht dhe gjithënjë e më shumë në kërkim të vetvetes, në mënyrë të pavarur. Për atë kohë sa femija nuk ka krijuar akoma "Unin" e vet, jeton me atë të nënës. Në këtë fazë ai mendon: -Dritani i vuri lodrat në vendin e vet. Me këtë ai mendon vetveten. Kur ai fillon të men-

dojë se: -Unë i vura lodrat në vendin e vet, do të thotë se ai ka filluar të formojë identitetin e vet pra, ta njohë vetveten i pavarur nga nëna.

Sipas specialistëve, shqetsimet e personalitetit të njeriut, fillojnë në fazën e femijërisë së hershme, atë të qumësht-thithjes. Nëse femija nuk perjeton fenomenin e simbiozës, pra, nëse nëna, në vend të ndjenjës së sigurisë i tregon atij atë të pasigurisë dhe trishtimit, ai mbetet me ndjenjën e vet të frikës dhe pasigurisë. Sipas traditës shqiptare, i ndja e djalit është gëzimi i shtëpisë dhe e vajzës merzija, trishtimi. Në shumë familje, këtë trishtim vajzat do ta vuanë gjithë jetën e tyre. Ato do të trajtohen si dorë e dytë dhe e tretë në familje. Nuk perjetojnë dashurinë prinderore dhe do të trajtohen me ato që teprojnë. Nëse tepron gjë. Mungesa e furnizimit me dashuri dhe dashamirësi, e perkëdheljeve, e urimit të mirëseardhjes nga shkelqimi i syve të nënës, e perkujdesjes se perhershme, në rradhë të parë dhe mbi të gjitha, shkakton ndjenjën e frikës e cila do të bëhet ndjenja dominante tek femija, për gjatë gjithë jetës së tij. Edhe nëse ai dikur do të mund ta mposhtë disi këtë frikë në aparençën e jashtme, kjo nuk do të thotë se ai e ka mposhtur frikën. Në nënvetëdijen e tij ajo jeton dhe kërkon gjithënjë që me dhunë të dalë në sipërfaqe. Kjo ndjenjë çliron energji negative shperthyes, energji e cila drejtohet kundër vet personit ose, nga ai tek dikush tjetër. Ai nuk e krijon dot ekuilibrin e brëndshëm dhe vuan nga mungesa e stabilitetit. Të gjitha fazat e tjera të zhvillimit të personalitetit të njeriut ndikohen fuqishëm nga ajo e femijërisë së hershme. Në fazën e puber-

tetit femija fillon të përjetojë identitetin e vet duke ja kundervënë atë prinderve dhe edukatorve. Ai mundohet ti mposhtë ata, duke i menduar si pengesa në realizimin e dëshirave të veta (Nëse do të mund ta mposhti nënën, atëherë nuk do ta humbi atë). Me këtë motiv ata mundohen që të sillen me cilindo. Femijët e braktisur nga dashuria prinderore, në të shumtën e rasteve janë agresiv (brutal) ose depresiv. Rast pas rasti, ata mund ta orientojnë agresivitetin e tyre ndaj vetvetes ose, jsthtë vetvetes, ndaj të tjerëve. Ata që agresionin e drejtojnë ndaj vetvetes, janë ata që ne i mendojmë kokëfortë, të pabindur, dhe që i bien murit me kokë. Janë superaktivë, të paorientuar dhe të pallogaritshëm. Ndjenja e frikës se do të keqtrajtohen apo rrihen dhe zhduken nga të tjerët, i bën ata shumë brutalë dhe të dhunshëm në sjelljet me të tjerët. Për të mposhtur ndjenjën e frikës ata janë gjithënjë në aksione të dhunshme, menderisht dhe fizikisht. Ata krijojnë vështirësi kudo dhe me cilindo që do të kenë të bëjnë, në familje, kopësht, shkollë, punë dhe kudo. Edhe me natyrën dhe gjallesat e saj.

Shoqëria njerzore, mund të prodhojë çdo gjë por jo njerz. Ajo i merr ata nga prehërat e nënave. Se si do të jetë shoqëria e jonë, kjo do të varet shumë nga prodhimi njerzor i nënave. Qytetrimi i nacionalitetit është fshehur në qumështin e nënave. Sipas Freudit, mardhenjet e hershme prinder femijë, janë ato që do të percaktojnë se kush do të jetë femija kur të rritet ... Pa represion dhe sublimim nuk mund të ketë civilizim.

Nga Lekë Imeraj
shkrimtar dhe perkthyes

Shqipëria në kërkim të një identiteti



Kanë kaluar tashmë 100 vjet që nga Shpallja e Pavarësisë, 100 vjet që nga viti kur Shqipëria i deklaroi botës se ishte një popull me një identitet tjetër, i cili kërkonte të ishte i lirë dhe i pavarur.

Pikërisht kjo ishte dhe pikënisja ku Shqipëria filloj kërkimin e identitetit të saj të të dërmuar nga koha. Por që të formohet një identitet kombëtar një bashkësi njerëzish kërkohet të kenë një histori, një gjuhë, një kulturë të përbashkët dhe të dallueshme nga nacionalitetet e tjera.

istoria e popullit shqiptarë është e vjetër sa vetë historia e kontinentit Evropian. Ajo fillon që me pellazgët stërgjyshit e shqiptarëve të sotëm dhe populli më i vjetër në Ballkan. Më pas vijnë Iliret një popull barbar sipas grekëve, jo si ideja e sotme për ta, por thjeshtë një popull jo-grek, sepse nga ana e organizimit shtetëror dhe social Iliria kishte të njëjtin zhvillim. Me Ilirinë madhështore nisë dhe cungimi i territoreve të banuara nga shqiptarë. Nga lindja vijnë sllavët të cilët me dhunë i morë tokat e begata dhe e quajtën atë tokë të

vjedhur mëmëdhe dhe ne fund legjionet te mbushura me njerz çeliku të i perkisnin asaj që do të bëhej perandoria më fuqishme që është parë në Evropë, e cila i dha fund Ilirisë së drobitur dhe të pafuqishme nga lufta. Koha kaloi dhe perandoria dikur madhështore e Romës Perëndimore ra, por Shqipëria mbeti si një provincë skajore e Perandorisë Bizantine. Në këtë kohë vendi ishte i ndarë në principata që filluan të pavarësoheshin dhe të luftonin me njëra-tjetrën. U desh një rrezik i jashtëm dhe një burrë që ti bashkonte këta princër egoist. Si çdo rast ku historia merre një kthesë 180 gradë, njeriu i duhur vjen në kohën dhe momentin e duhur. Çallmat e jeniçerëve osman kishin pushtuar Ballkanin dhe po përgatiteshin për një ndërhyrje në Evropë, por një vend i vogël si Shqipëria u kthye në një pengesë të pakalueshme, kjo falë figurës së heroit tonë Nacional Gjergj Kastrioti. Ai bashkoi Shqipërinë në një flamur të vetëm dhe duke e shndërruar Shqipërinë në një mburojë hekuri dhe mishi për gjithë pjesën tjetër të Evropës. Megjithatë jeta e një njeriu nuk është e gjatë sa një periudhë historike dhe me vdekjen e Gjergj Kastriotit nisën dhe 500 vjetët e rënkimit të identitetit shqiptarë, gjithçka shqiptare mohohej, shkelej me këmbë qoftë me dëshirë, qoftë me pahir. Fatmirësisht, për Shqipërinë dhe shqiptarët, përfaqësuesit shqiptarë në Portën e Lartë e kuptuan se duhej të shpallej autonomia e Shqipërisë dhe të hidhet shikimi andej nga e hodhën rilindësit andej nga perëndon. Kështu me 28 nëntor, 100 vjet nga sot në Vlorë u Shpall Pavarësia duke u krijuar Shqipëria që njihet sot ku vetëm gjysma e trojeve, shq-

iptare u përfshin në këtë shtet sipas tekave të Fuqive të Mëdha. Kalvari i vuajtjeve nuk mbaron këtu, sepse Shqipërinë e ndjekin dy pushtime njëri pas tjetrit dhe ne fund vendoset një shtet policorë që vret qytetarët e vet, u bën lavash truri duke i shndërruar popullin në marioneta ku telat e kontrollit ishin në dorën e pak personave. Por në vitin 1990 gjithçka ndryshoi, Shqipëria doli nga inkubatori ku ishte futur, hodhi sytë përsëri nga Perëndimi dhe tashmë përballet me realitetin e ri.

Por nuk është vetëm historia e përbashkët që krijon një nacionalitet, por është ai që quhet elementi i parë i nacionalitetit, gjuha. Gjuha shqipe mund të konsiderohet një gjuhë e rrallë njëlloj si një specie endemike, një degë e vetme në pemën e gjuhëve indo-evropiane, e cila nuk ka asnjë të ngjashme. Nga ana tjetër, me një fuqi të jashtëzakonshme shprehëse, por e cila nuk përdore në masë të gjere potenciali i saj. Ndoshta kjo vjen si shkak i periudhës globaliste, në të cilin po jetojmë dhe përdorimi i fjalëve të huaja ose me prejardhje te huaj është kthyer në modë duke harruar se çdo fjale e huaj e gjen sinonimin e saj në gjuhën shqipe për shkak të leksikut te saj të gjerë. Gjuha në vetvete bën pjesë në një fushë më të gjerë që është kultura.

Kultura e popullit shqiptarë ashtu si dhe vetë gjuha janë tepër të rralla. Kjo shprehet në doke, zakone, tradita dhe sidomos në disa sjellje sociale si besa, mikpritja, e cila tashmë është pjesë e jona dhe e karakterit tonë që e njohin të gjithë të huajt, por gjithashtu edhe plagë të vjetra të shoqërisë tonë si gjakmarrja që është një plagë. që e kemi trashëguar që nga lashtësia. Gjithash-

tu, kultura shprehet dhe në arte, muzika e jonë e krijuar me lahute, çifteli apo edhe vetëm me zërin e gojës së është polifonia labe, kënga maja-krahu e te tjera, të cilat kane ruajtur vlerën tone nacionale kulturore, e ne veçanti polifonia labe, e cila ruhet nga UNESCO; kostumografia e larmishme, kinematografia, ku të shumtë janë filmat shqiptarë të realizuar në mënyrë mjeshtërore.

Pavarësisht, Shqipëria kërkon ta gjejë identitetin e saj në familjen e madhe evropiane. Identiteti evropian nuk është gjë tjetër veçse një grumbull popujsh me identitete të ndryshme, me kulturë e gjuhë të ndryshme, ndoshta edhe me histori me konflikte në mes tyre, por që kanë aspirata të njëjta zhvillimin, prosperitetin dhe paqen.

Tani, mbi Shqipërinë rëndon pyetja: A do të arrij Shqipëria ta përvetësoj, ta metabolizoj këtë identitet? Mos të harrojmë se, Evropa i ka shumë borxhe Shqipërisë, herë e ka përdorur si mburojë, herë si trofe duke e ndarë plaçkë lufte mes fitimtareve dhe duke kryer padrejtësitë më të mëdha me vetëdije të plotë. Populli shqiptar është martiri i sakrifikuar dhe madje ai ka qenë një prej krijuesve të këtij identiteti, te identiteti evropian, prandaj ai ndodhet në kulturën tonë, në mënyrën sesi jetojmë, si sillemi ne raport me të tjerët, thjesht kërkim vullnet që çdo shqiptarë të tregoj se, di të jetë një qytetarë evropian dhe të sillet si i tillë.

Nga Ermal Fierza

Koshienca mbi vetveten..., ndryshe kur mbetemi pre e filozofisë së robërisë

Nga KADRI UJKAJ

Kur dimë se tradita në shoqëritë e vërteta demokratike vlerësohet si hipotezë pune, në të cilën natyra e vendos njeriun apo popujt para të gjitha gjërave, sikurse Autoritetin e konsideron si hipoteza e leximit të realitetit, ndryshe si mundësi e verifikimit dhe e prosperimit konstruktiv me këmbë mbi tokë, tek ne shqiptarët ku, siç do të shprehej Profesor Arshi Pipa, politikanët tanë s'arritën asnjëherë "zëvendësimin, nga ana e tyre, të pushtetarit provincial me atë të ideologut nacional", ndodh krejt ndryshe: Ne i fshihemi Traditës, sikur vazhdojmë t'i servilosemi Autoritetit dhe me tragjikomicitetin tonë, si hipokritë të epokës postmoderne, s'ka asnjë gjasë t'i shpëtojmë atij identiteti kamaleon, nën trysninë e frikës apo mbijetesës si përshtatje të rregullit apo të drejtave tona zakonore, të trashëguara së brendshmi, me qeverisjet e ndryshme, të imponuara së jashtëmi, në mungesë të një përvoja evolutive apo shtetformimi nën rebelimin "e turmave", për ndryshim shoqëror, të cilin na e diktoi ndër breza të tërë statukoja e "më të dobët" përballë të të Mëdhenjëve, si pushtues, ndër shekuj.

Kështu, duke hedhur vallen e tjetërsimit postmodern, vazhdojmë të jetojmë kohën e një absurdi gjithnjë "origjinal", jo thjesht, pre e një mentaliteti patriarkal qindra vjeçar apo totalitar, gjysmë shekullor, por ajo, më bafasuesja në mrekullinë e saj "origjinale", vijon të gjallojë vizioni tragjikomik i "Kohës Zero", filozofia e të cilit lexohet rregullisht, filluar me fatin e Sheshit "Skënderbej" në kryeqendrën tonë, sa herë alternohet qeverisja në këtë vend: Si shkatërruam ç'gjë përpara të investimit totalitar në sektorë të arsimit, kulturës, ekonomisë, e të tjere. me fantazinë e sëmurë tragjikomike të "Çekut të Bardhë", po aq s'po lëmë moment serioz pa hedhur baltë mbi të apo shpërfillur deri institucionalisht, përfshirë edhe historinë tonë moderne, nën trysninë anakronike të antikomunizmit si dogmë.

Rrjedhimisht, të dehur nga entuziazmi modern, duke mos qenë të aftë, as në ditët tona, të duam si duhet vetveten, apo të vendosim bashkarisht, mjerimi sa psikologjik, sa politik, sa filozofik, është ulur këmbëkryq mes nesh: Ndryshe "... problemi është se masës së shqiptarëve, sikurse pjesës dërmuese të popullsisë së globit po i ndodh diçka paradoksale: Ka lirinë për të menduar, por nuk ka kushtet për të menduar si duhet arsyeshëm, sepse shoqëria e sotme nuk zhvillohet nga vetvetja, ndryshe shqiptari është qenie e rrahur paq, edhe pse ka pasur një kohë aty nga vitet 70-të apo 80-të, kur të flisje për "shqiptarin si të besës, ose të pabesës, gjakmarrës, ose gjakfalës, gjakxehtë apo gjakftohtë, kanunor apo institucional, mikpritës apo vëllavrasës, pra sipas një koncepti antropologjik me natyrë holiste, tërësore, ishte një emancipim, sepse ky këndvështrim ngrihej kundër stalinizmit që shqiptarin e shihte vetëm si produkt i luftës së klasave. Pra, ishte një formë disidence, edhe pse, mjerisht, pasi u bë

hapja demokratizuese, kjo lloj metode antropologjike për të gjetur shqiptarin si tipologji holiste, tërësore, mua më duket se po kthehet në një metodë dhe ideologji paksa konservatore" (Profesor Doktor Artan Fuga, sociolog, "Homos albanicus...", Gazeta "Shqiptare", më 22. 01. 2012).

Jemi, ndoshta, i vetmi nacionalitet në postkomunizëm, që akoma nuk po arrin të kuptojë se Fitorja mbi Nazifashizmin në Luftën II Botërore do të ishte mamia që shoqëroi lindjen e Evropës së Re, të vlerave iluministe, ku dëshirojmë të jemi edhe ne. Me shumë vend media, kohët e fundit, ka tërhequr vemendjen: "Komunizmi, si sistem, vërtet ishte një eksperiment totalitar, që në Kosovë mori ngjyrat e pushtetit serb, por, kjo nuk u lejon kurrsesi shqiptarëve të krahinës të vendosin si emra rrugësh Xhaferr Devën dhe Rexhep Mitrovicën. Këta kuislingë, përpara se të ishin nacionalistë dhe vrasës të serbëve, ishin vrasës të shqiptarëve. Atëhere ekstremi ynë i majtë s'ka pse të mos kërkojë vendosjen e emrave të Enver Hoxhës dhe Mehmet Shehut në rrugët shqiptare. Fundja, këta të fundit, nuk kanë qenë bashkëpunëtorë me pushtuesin nazifashist." (Dritan Hila, "Milosao", më 1. 04. 2012).

Ne nuk do të hynim në Hartën e Botës pa kontributin e shkëlqyer të popullit tonë, veçanarisht të partizanëve dhe nacionalistëve të ndershëm, pa ndihmën direkte të asnjë ushtrie të huaj, në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare, nën udhëheqjen e Partisë Komuniste Shqiptare, kur "... të gjitha Fuqitë e Mëdha: Gjermania hitleriane, Britania e Madhe, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Bashkimi Sovjetik, Franca, të pasuara nga shtete të dorës së dytë e të dorës së tretë, përfshirë edhe shtetet fqinje, me përjashtim të Egjiptit dhe Turqisë, dikush defakto, dikush de juro, do të njihnin pushtimin fashist të Shqipërisë më 7 prill 1939, çka do të sillte që shqiptarët ta ndjenë veten të braktisur, kur panë se Fuqitë e Mëdha të Kampit Antifashist s'po i trajtonin as si viktimën tjetër, Çekosllavakinë, e pushtuar nga fashistët më 15. 03. 1939. Madje ato s'pranuan as të njohin asnjë institucion që ta përfaqësonte Shqipërinë në mërgim si shtet i pavarur dhe sovran çka do të thoshte se Shqipëria s'ekzistonte më as si subjekt i të drejtës ndërkombëtare, sepse fati i saj u la në mëshirë të Italisë fashiste".

Dhe, megjithatë, për paradoks, para Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, njëherë nga faqet më të ndritura të historisë sonë moderne, që do të na rikthente pavarësinë e humbur nga pushtimi fashist, në epokën e Shqipërisë së Hapur para të tjerëve, ne, shqiptarët, vazhdojmë të jemi nihilistë e të mbyllur para vetvetes duke mos i bërë nderimin dhe vlerësimin e merituar, ngaqë në krye të kësaj ngjarje të madhe, për hir të së vërtetës historike, duhet artikuluar emri i organizatorit kryesor të saj, gjeneral-kolonel Enver Hoxhës: "Një figurë interesante, një personalitet që të imponohesh me intransigjencën, por edhe me intelgjencën e kulturën, që

njihte shumë mirë gjuhën, kulturën dhe historinë e Francës, një njohje që do ta dëshironte e do ta kishte zili edhe francezi më i kulturuar. Ai ishte padyshim ndër udhëheqësit më të aftë e më të ditur, por fatkeqësisht ishte komunist dhe ideologjia nga e cila ai udhëhiqej, nuk kish të ardhme" do të shkruante pas Luftës ... shefi i misionit ushtarak, aleat, anglez Palmer. "Politika e tij që ... nacionaliste, në interes e në dobi të vendit të vet", nënvizonte oficeri i Shërbimit të fshehtë Informativ, Reginald Hibbert, i misionit anglez në Shqipëri gjatë Luftës II Botërore. Për shqiptarët, një nga popujt më të vjetër të Evropës, shteti i tyre, një nga më të rinjtë e saj, ishte një farë fati i keq. Ekzistencën e vendit të tyre e fshiu Italia më 1939. Pika e kthesës ndodhi në vitet 1943 dhe 1944, kur lufta partizane dhe interesimi për të nga ana e Britanisë së Madhe dhe e SHBA e bënë të sigurtë se vendi do të ringjallej brenda kufinjve të para vitit 1939 ... Shqetësimi i parë i udhëheqësve komunistë shqiptarë në vitet e para të pas Luftës, ose të paktën shqetësimi i kryesorit ndërmjet tyre, i Enver Hoxhës, ishte që të shmangte përqafimin dhe gëlltitjen nga Jugosllavia. Ata që do të dëshironin të kuptonin fenomenin shqiptar ... feniksi u ringjall nga flakët më 1944" (Libri "Fitorja e Hidhur – Lufta Nacionalçlirimtare Shqiptare", fq. 11-13).

Gjatë kësaj lufte, siç thekson në kujtimet e veta Gjeneral Rrahman Pëllaku, ish-ushtarak madhor, i dënuar nga regjimi i diktatorit tonë, "askush nuk dënohej pa vendim dhe pa u bindur se ishte kundër luftës dhe në shërbim të okupatorit nazifashist. Lufta nuk ishte terror, të vrasim këtë e të vrasim atë". Të jesh korrekt, objektiv, në kontekstin e lartpërmendur, nuk do të thotë se po injoron faktin që diktatori ynë (diktaturë e proletarietit thirrej modeli totalitar) përfundoi si prototipi i njeriut të shpërfytyruar mizorisht nga pasojat e një qëndrimi aq të gjatë në pushtet", në formatin e "një diktatori nacionalist ksenofob, jo komunist, i ngjashëm me Stalinin, Maon dhe Kimët e Koresë së Veriut, por jo me Gierekun, Dubčekun apo Kadarin, të gjithë ish-komunistë reformatorë ...

Megjithatë E. Hoxha, në kontekstin e njohur të Luftës II Botërore si lideri kryesor i LANÇ-it, e njohur nga aleatët, pavarësisht lëkundjeve të ndryshme, do të mbështeste dhe vlerësonte kontributin e tyre në këtë rast: "Pa luftën që bën aleatët e mëdhenj, - do të deklaronte ai -, dhe pa ndihmën e tyre, lufta jonë s'do të merrte përmasat që mori, nuk do të mund të arrinte objektivat dhe synimet që kishte. Sikurse nuk mund të injorohet zhvillimi i dyshimit metodik ndaj aleatëve, si veprim serioz, nga ana e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Antifashiste Nacionalçlirimtare Shqiptare, dhe e vetë E. Hoxhës, si komandant i këtij shtabi, në këtë kontekst, kur, siç dihet, bie fjala, "... misionarët anglezë, në funksion të planeve të veta strategjike dhe operative, erdhën, sigurisht, për të inkurajuar rezistencën në prapavijat gjermane, por po aq edhe për të përgatitur ardhjen në pushtet të një klase politike, të

shitur e të korruptuar, e cila, - siç shprehet akademiku ynë i shquar, Profesor Doktor Pëllumb Xhufi, - ishte në gjendje, që pas luftës të nënshkruante çdo projekt të hartuar nga Turçilli për rregullimin e Ballkanit të pas luftës, sigurisht, në dëm të Shqipërisë ..." (Gazeta "Shqip", më 8. 07. 2012).

Prandaj, në këto rrethana decizive për fatin e së ardhmes sonë, si nacionalitet, duhet pohuar se qëndrimi dhe roli historik i E. Hoxhës që krejt e kundërta e Ahmet Zogut: "... figurë historike, më pak e rëndësishme, një monark i pailuminuar dhe jonacionalist, i cili iu shmang historisë sonë nacionale në një moment vendimtar për popullin shqiptar, kur si mbret i vetshpallur, duhej ta udhëhiqte popullin e tij në luftën kundër pushtuesit fashist dhe jo ta grabiste e ta braktiste atë ... (Prof. Dr. F. Tarifa, sociolog, Sekretar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Shqipërisë, "Milosao", më 22. 01. 2012) duke marrë me vete edhe 150 baule dhe valixhe me sende personale" si dhe 7 arka me flori. Qarkullonin zëra, se veç arkave me flori, një qypi të madh gurësh me vlerë, kishte dhe depozita në banka amerikane dhe angleze, në 10 milionë dollarë e 4 milionë stërlina. Burime të shumta tregojnë se mori me vete gjithë pasuritë e vendit dhe thesarin" (Prof. A. Puto "Shkurorëzimi i mbretit Zog në mërgim", fq. 20). Kështu që qëndrimi i mbretit shqiptar si kryetar shteti "kur ishte i detyruar të mos i shmangej detyrës, të përballë me rrezikun, të mbrojtë vendin e vet; sepse për këtë ishte betuar para flamurit dhe shkelja e betimit përbënte në atë kohë, sikurse përbën edhe sot, krim ndaj Atdheut dhe shtetit shqiptar.

Po, ikën edhe mbretërit e tjerë?; po, po, por ata rezistuan deri në falimentim kundër okupatorit fashist, kujtojmë rastin grek dhe serb në prill 1941, ku mbretërit e tyre, pasi rezistuan 2-3 javë në ballë të luftës antifashiste në vendet e tyre, të pushtuara, u larguan vetëm pasi lanë në këmbë një rezistencë me strukturat përkatëse, pra gjithësesi, pavarësisht lëkundjeve e problemeve, vazhduan të mbeten faktorë rezistence deri në përfundim të luftës, kurse mbreti ynë nuk do të denjonte të rezistonte as 5 ditë qoftë edhe i tërhequr, diku në male, çka do t'i shpëronte nderin atij vetë dhe vendit të tij" siç do ta qortonte Zogun, asokohe, Presidenti turk, İnönü. Ky është ndryshimi, kjo që arsyeya pse mbretërit e vendeve fqinje u pranuan në Londër jo si Ahmet Zogu, por me të gjitha të drejtat e uzurpuara nga okupatorët, kurse mbreti ynë vetëm si qytetar i thjeshtë, të cili iu ndalua të merrej me politikë përsa kohë do të qëndronte aty". (Prof. Dr. Xh. Gjeçovi "Pavarësia, mbretëria dhe lufta", fq. 12).

Franca moderne do ta nderonte marshallin dhe politikanin e famshëm Filip Pëten, i njohur për rolin e tij në mbrojtje të Verdunit (1916), ndryshe si shpëtimtarin e Saj nga pushtimi gjatë Luftës I Botërore, por kurrsesi nuk do t'ia falte bashkëpunimin me gjermanët, si kryetar i qeverisë kuislinge të Vishisë gjatë Luftës II Botërore duke e dënuar me vdekje në moshën 90-vjeçare dhe, më pas, me burgim të përjetshëm, ku edhe vdiq. "Jepini Çezarit atë që i takon!", - porositte Krishti.

(vijon në numrin e ardhshëm)

HISTORINË DUHET TA RISHIKOJË JO I SUNDUARI, POR SUNDUESI

Nga XHELAL ZEJNELI
(Botohet me shkurttime)

Autoritetet e sotme të Ankarasë kërkojnë prej shqiptarëve të riinterpretojnë historinë kombëtare që ka të bëjë me periudhën osmane. Me fjalë të tjera, ata kërkojnë prej shqiptarëve ta ndryshojnë historinë e vet. Këtë kërkesë turqit e bëjnë nga pozicioni i forcës.

Krahas shqiptarëve, në gadishull jetojnë edhe popuj të tjerë. Një kërkesë të tillë Turqia, të paktën publikisht, nuk ia ka bërë asnjë populli tjetër të rajonit, si për shembull grekëve, rumunëve, serbëve, bullgarëve etj. Një kërkesë e tillë popujve të sipërthënë as që mund të paramendohet.

Historinë e vet - nën trysni - e ndryshojnë vetëm popujt e parëndësishëm. Shqiptarët nuk bëjnë pjesë në këtë kategori popujsh. Janë popull i lashtë dhe rrënjës në gadishull, në brigjet e Jonit dhe të Adriatikut. Janë racë ariane, indoeuropiane. Prej popujve të tjerë i dallon gjuha, e cila është mu në rrënjë të trungut gjenealogjik të gjuhëve indogjermane. Rrjedhimisht, janë populli më i rëndësishëm i rajonit.

Periudha osmane e historisë së popullit shqiptar është hartuar dhe është shkruar me kritere shkencore, nga dijetarët më eminentë të kombit. Në të nuk mund të gjes as edhe një fyerje të vetme ndaj pushtuesve dhe sunduesve osmanë.

Kërkesa e Ankarasë nënkupton revidimin e historisë, që nga periudha luftërave të Gjergj Kastriotit, e deri në shpalljen e pavarësisë. Kjo paraqet *çistorizimin* e popullit shqiptar dhe zhveshjen e tij nga një pjesë e madhe e historisë së vet kombëtare. Të kërkojnë prej një populli të ndryshojë një histori pesëshkulllore, do të thotë ta lësh atë popull *pa histori*. Një popull që do të pranononte ta ndryshojë historinë e vet pesëshkulllore, mbetet pa histori dhe *çistorizohet*.

Nuk kanë qenë shqiptarët pushtues dhe sundues të Turqisë. Përkundrazi, është Perandoria Osmane ajo që e pushtoi Shqipërinë - madje pas një qëndrese çerkeshekullore. Dhe nëse duhet ndokush ta ndryshojë apo ta riinterpretojë historinë, këtë duhet ta bëjnë turqit dhe jo shqiptarët. Këtë pra, duhet ta bëjnë ata që kanë pushtuar toka të huaja dhe që kanë sunduar mbi popuj të tjerë. Dhe jo të sunduarit - shqiptarët. Kjo i ngjan rrëfimit të ujkut dhe të qengjit: "Mos ma turbullo ujën" - i thotë ujkut qengjit!

Epoka osmane e historisë së popullit shqiptar shquhet për dy periudhave të lavdishme, e para, periudha *zulmëmadhe* e luftërave të popullit shqiptar nën udhëheqjen e *Gjergj Kastriotit* kundër pushtuesve osmanë, që në letërsinë dhe në artin shqiptar është quajtur *moti i madh*, e dyta, periudha e *Rilindjes Kombëtare Shqiptare*, që fillon në vitet dyzet të shekullit XIX.

Pa epokën e lavdishme të Gjergj Kastriotit, populli shqiptar nuk do ta kishte periudhën e Rilindjes Kombëtare. Ndërkohë, pa periudhën e Rilindjes Kombëtare, shqiptarët nuk do ta kishin pavarësinë. Arritje e rilindësve shqiptarë është pavarësia e Shqipërisë (1912), d.m.th. shteti shqiptar.

Shteti - gjëja më e shtrenjtë dhe më e shenjtë e një populli.

Me fjalë të tjera, epoka e Kastriotit në

shekullin XV, periudha e Rilindjes Kombëtare në shekullin XIX si dhe shpallja e pavarësisë në fillim të shekullit XX, janë tri verigat kryesore të zinxhirit historik të popullit shqiptar për t'u çliruar nga zgjedha osmane.

Pa *Gjergj Kastriotin* shqiptarët nuk do ta kishin as *Rilindjen Kombëtare*; pa Rilindjen Kombëtare nuk do të kishin as *shtet*. Shqipëria do të shlyhej nga harta politike e Ballkanit. Si disa popuj të tjerë pa shtet, edhe shqiptarët - të përbuzur - do të endeshin udhëkryqeve të botës.

Një popull që është çliruar nga sundimi i huaj, historinë e shkruan ashtu si do vetë dhe jo si ia diktojnë të tjerët. Aq më pak - pushtuesit dhe sunduesit. Natyrisht, duke u bazuar në argumente shkencore.

Kërkesa turke për ta riinterpretuar historinë, një ditë do të shtrihet edhe në rrafshin e *letërsisë* dhe të *artit*. Letërsia shqiptare e periudhës së Rilindjes Kombëtare, sikundër edhe e popujve të tjerë të gadishullit, ndërlihet ngushtësisht me synimet për t'u çliruar nga sundimi osman. *Romantizmi* në letërsinë shqiptare, që lindi me *Jeronim De Radën* në vitet '30 të shekullit XIX ndër arbëreshët e Italisë, trajtoi temat që janë tipike për këtë drejtim letrar dhe artistik, siç janë: tema e historisë, tema e së kaluarës së lavdishme, e lashtësisë së popullit, e prejardhjes, e figurave historike, e gjuhës, e traditave dhe e virtyteve të popullit. Figura qendrore e letërsisë shqiptare të drejtitimit letrar të romantizmit është ajo e Gjergj Kastriotit. Ky personalitet vigan i historisë së popullit shqiptar ka qenë burim frymëzimi për studiuesit dhe për krijuesit artistikë shqiptarë, që nga *humanistët* shqiptarë në qindvjeçarët XV-XVI e deri në ditët tona.

Ç'nënkuptojnë turqit me revidimin e historisë së popullit shqiptar?!

Të hiqet përmendorja monumentale e heroit të tyre kombëtar nga fortesa e Krutës legjendare që përjetoi tre rrethime (1450, 1466, 1467) në të cilat morën pjesë vetë Sulltan Murati II dhe Sulltan Mehmeti II (pushtuesi i Kostandinopojës). Të hiqet kryetrimi kombëtar nga sheshi i Tiranës, i Prishtinës, i Shkupit dhe i Dibrës?! Të shmanget *antemurales* i *qytetërimit perëndimor* nga sheshet anembanë metropoleve të Evropës?!

Ç'do të thotë *ndryshim* i historisë?!

Të digjen si në mesjetë, sipas *Index librorum prohibitorum* - poemat e letërsisë shqiptare që kanë për protagonist qendror figurën e kryezotit të mesjetës?! Figura e Gjergj Kastriotit është trajtuar artistikisht nëpër shekuj edhe nga krijues letrarë dhe artistikë të huaj. Por, ndikimi i Ankarasë nuk shtrihet deri atje.

Luftërat antiosmane të shqiptarëve për liri u trajtuan në mënyrë artistike nga poetë, romancierë, dramaturgë, piktorë, skulptorë. Sot, kur ish-sundimtarët e kanë marrë veten, a duhet vallë që edhe veprat e krijuesve artistikë të asgjësohen?!

Ç'ndodh sot?! Po ndodh diçka absurde dhe e pabesueshme!! Disa historianë shqiptarë të specializuar për periudhën osmane të popullit të vet (*osmanologë*) ngulmojnë se kjo periudhë për shqiptarët nuk ka qenë sundim por administrim. Sot, vetë shqiptarët i konfirmojnë shkrimet kuazi-

+

shkencore të studiuesve sllavo-bizantinë për periudhën osmane të historisë së popullit shqiptar. Tash e tutje, kundër interesave jetike të shqiptarëve, s'ka nevojë më të shkruajnë serbët, grekët dhe rusët. Kështu sepse, *këtë e bëjnë me devotshmëri vetë shqiptarët*. Janë i vetmi popull i rruzullit që lufton kundër vetes e që vë në lojë identitetin e vet!! E paparë kjo, në historinë e botës!! Me pikëpamjet kundër vetes, shqiptarëve do t'u a kishin zili edhe akademikët serbë.

Historinë e popullit shqiptar nuk e krijuan ata që i qëndruan besnikë *Portës së Madhe* edhe pas shembjes së saj. Histori krijuan dhe në histori hyrën ata që kishin ideale të larta dhe që u flijuan për kauzën e madhe. Vepra historike nuk krijojnë ata që luftojnë për interesa mesquine, por ata që kanë ideale madhore.

Po qe se sundimi osman mbi shqiptarët paska qenë administrim dhe shpëtim, atëherë çka i shtyri shqiptarët që në periudha të caktuara të çohen në *kryengritje antiosmane*?! Cila e mirë i shtyri t'i lënë vatrën stërgjyshore?!

A ka qenë prania osmane sundim ose jo, këtë e kanë ditur më së miri ata që janë ballafaquar me formacionet e ndryshme të ordive perandorake, si dhe me pushtetin perandorak. *Frang Bardhi* është autor i fjalorit të parë shqiptar *Dictionary latino epiroticum, Romë 1635*. Kjo është e para vepër në gjuhën shqipe pa përmbajtje fetare të drejtpërdrejtë. Ndërmjet tjerash, vepra përmban edhe 113 proverba dhe fjalë të urta (e para përmbledhje e tillë). Një prej fjalëve të urta, përkatësisht sentencave që e ka thënë populli shqiptar para rreth 400 vjetësh, thotë: "Tek shkel turku, nuk mbin bar".

Një perandori, për t'u konsideruar dobi-prurëse për një popull që ka qenë pjesë e saj, duhet që pas shpërbërjes, populli i sunduar (apo edhe i administruar): të ketë ruajtur njësinë tokësore, të ketë ruajtur gjuhën, të ketë ruajtur fenë e të parëve të vet, të ketë ruajtur folklorin dhe etnografinë e vet, të ketë ruajtur kujtesën historike, të ketë krijuar klasë dhe elitë intelektuale, të ketë krijuar klasë dhe elitë politike, të ketë krijuar determinantë historikë dhe sociologjikë, të ketë shënuar zhvillim ekonomik, të ketë ruajtur vetëdijen kombëtare, të ketë ruajtur identitetin kombëtar, të ketë ndërtuar institucione kombëtare.

Në çastin e shpërbërjes së perandorisë, populli që i ka ruajtur apo që i ka krijuar vlerat e sipërthëna, ka mundësi të rezultojë si subjekt politik i mëvetëshishëm.

Gjatë sundimit të Perandorisë Osmane, shqiptarët nuk krijuan *institucione kombëtare*, në zona urbane të caktuara, në vend të *gjuhës shqipe*, mbizotëroi *turqishtja*, një pjesë e shqiptarëve u *konvertuan* në fenë islame, në rajone të caktuara u godit rëndë *kujtesa historike* e shqiptarëve, shqiptarët nuk arritën të krijojnë *klasë dhe elitë intelektuale* relevante, shqiptarët nuk arritën të krijojnë *klasë apo elitë politike* kombëtariste që do të mund të ishte në krye të përgjegjësisë historike, në *shekullin e kombeve* (shek XIX), për dallim nga popujt e tjerë të Ballkanit, shqiptarët nuk patën elitë politike nacionaliste, shqiptarët nuk arritën të krijojnë *determinantë sociologjikë dhe historikë* që do të ishin promotorë të proceseve politike, u rrezikua edhe *vetëdija kombëtare* e shqiptarëve, u rrezikua edhe *identiteti kombëtar* i shqiptarëve, në kohën kur Turqia e humbi *luftën ballkanike* (1912) dhe Shqipëria pas *kryengritjeve të përgjithshme antios-*

mane (1909-1912) u shpall e pavarur, *shqiptarët nuk ia dolën të ruajnë tërësinë tokësore*.

Nga kjo rezultoi se periudha osmane për shqiptarët ka qenë pushtim dhe sundim.

Një popull që ndryshon historinë e vet mohon veten, punon kundër vetvetes, manifeston krizë identiteti dhe vë në dyshim qenien kombëtare.

Përshtatja e historisë objektive turke do t'i konfirmonte pohimet serbe dhe greke se shqiptarët janë *përçues* të interesit turk në rajonin e krishterë dhe në Evropën katolike e protestante.

Në fund të fundit, Ankaraja nuk duhet të brengoset gjithaq për rishqyrtimin e historisë së popullit shqiptar. Kështu sepse shqiptarët, edhe pa këtë rishqyrtim, *nuk e dinë sa duhet* historinë e vet. Sikur ta dinin, një kërkesë e tillë nga pushteti turk as që do të shtrohej.

Me ardhjen e turqve në gadishull, u ndërpre në lule të moshës veprimtaria e humanistëve shqiptarë - *Gjon Gazullit, Marin Barletit, Mikel Marullit, Zenk Tomeut, Maksim Grekut, Marin Beçikemit*.

Sundimi osman mbi shqiptarët e ndërpreu edhe traditën e shkrimit shqip të filluar nga *Gjon Buzuku, Pjetër Budi, Frang Bardhi, Pjetër Bogdani*. Lidhjet e shqiptarëve me botën perëndimore - u ndërpreu.

Sipas përfaqësuesve të mendimit politik shqiptar, islamizimi i shqiptarëve paraqet për ta *aksident historik* që e ndërpreu zhvillimin e shqiptarëve në frymën perëndimore, e vështirëson riintegrimin e shqiptarëve në familjen perëndimore.

Përkundër kësaj ndërprerjeje, do të ishte *johistorike* ta projektosh pozitën e shqiptarëve jashtë gjirit perëndimor.

Gjatë sundimit osman shqiptarët u asimiluan, jo vetëm në pikëpamje fetare por edhe në atë kombëtare.

Tragjizmi shqiptar arriti kulmin në Londër (1912-1913), kur trojet e Arbërisë u *ndanë* në katër copa: në gjysmë-Shqipëri, në Greqi, në Serbi dhe në Mal të Zi. Më vonë edhe në dy copa të tjera: në Kosovë Lindore dhe në Maqedoni. Gjithsej gjashtë. Si asnjë popull tjetër në botë.

Për këtë tragjedi të popullit shqiptar, *autoritetet turke duhet t'u kërkojnë shqiptarëve falje* dhe jo riinterpretim të historisë. Tragjizmi shqiptar troket në ndërgjegjen e Ankarasë së sotme.

Shqiptarët në Ballkan dhe në diasporë flasin një gjuhë, kanë një histori dhe janë një komb.

Po qe se autoritetet e Prishtinës do ta zbatonin kërkesën turke për riinterpretimin e historisë, kjo do të shkaktonte përçarje edhe ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës.

Çështja e rishikimit, e rishkrimit dhe e riinterpretimit të historisë së një populli nuk është çështje politike, por *shkencore*. Me historinë duhet të merren historianët dhe jo politikanët. Rishikimi i historisë së një populli është e drejtë dhe detyrë e institucioneve shkencore të një kombi, siç janë Akademia e Shkencave, institutet përkatëse, katedrat e universiteteve, nën premisën që të jenë jashtë ndikimeve politike.

Ndryshimi i historisë shpie në përsëritjen e saj.

Për të kërkuar riinterpretime të historisë, pushtuesit dhe sunduesit problemet e popujve që aspirojnë lirinë duhet t'i zgjidhin me *dialog* dhe jo me politikën e forcës. Nuk burgoset një popull i tërë. Aq më pak në shekullin XXI.

+

KONTRIBUTI I LUFTAREVE TE MALSISE GJAKOVES NE BASHKEPUNIM ME PLAVEN E GUCIN GJATE VITI 1912 PER LIRI DHE PAMVARSI



Nga Ibrahim Hajdarmataj

Që në kohët e hershme Plava ka qenë e banuar nga Shqiptarët, por pas Kongresit të Berlinit (1878), Plava i bashkohet Malit të Zi, ku deri në ditët e sotme ka mbijetuar me problemet që ka pasur.

Sot popullsia Shqiptare është në këtë komunë rreth 20% përqind, kryesisht të përhapur në fshatrat Vuthaj, Martinaj, Plavë dhe në Guci. Që nga viti 1913 Plava me rrethinë është në administratën malazeze. Kjo trevë etnike shqiptare qysh në lashtësi ka qenë e njohur me emrin "Vuthaj" ose "Katundi Vuthaj". Duke pasur parasysh shtrirjen, e territorit dhe të banorëve, distancën nga njeri katund tek tjetri, themi se është një krahinë e vogël shqiptare në zemër të alpeve, me bukuri mahnitëse.

Etimologjia e toponimit "Vuthaj" e ka trajtuar edhe Prof. Eqerem Çabej, në veprat e tij në Tiranë, i cili thotë se ky toponim vjen nga fjalët: "I vutë", "I përvutë". Një ndër figurat me të rendësishme të kësaj treve mbetet ALI BEG GUCIA, pjestar i KRIJIMIN TE LIDHJES SHQ-

IPITARE TE PRIZERENIT, me 10 Qershor 1878, i cili ishte mik dhe bashkëpunues i ngushtë me krerët udhëheqës të Malsisë të Gjakovës.

Vuthjant, kane qenë të njohur për përkushtimin ndaj atdheut dhe lirisë, për njerzillekun, burrërinë, ndershtetësinë, besnikërinë, sinqeritetin, mirkuptimin njerëzor, vendosmërinë për të mbrojtur të drejtat e tyre deri në fund, ndenjën e dashurisë për njeriun, dashurinë ndaj trashëgimisë që ju kanë lënë të parët, ndaj tokës amtare, vendosmërinë për të luftuar të keqën, dëshirën për të mësuar e përparuar, luftën ndaj padrejtsisë, dhunës, shtypjes, rrënës, pabesisë dhe vjedhjes.

Janë shumë kuptimplote dhe vlersime që bënte Anton Ceta, i cili shkruante, se nga Vuthjanët kishte frikë edhe Veziri i Shkodrës.

Unë do të ndalem kryesisht në kontributin e dhënë për kryengritjen e përgjithshme të vitit 1912.

Në fill të mujit maj të vitit 1912 udhëheqësit e forcave kryengritëse të Malesisë të Gjakovës në bashkëpunim me Plavën e Gucinë, ishin të parët që drejtuan thirrje popullit shqiptarë për një kuvend mbarë kombtarë.

Kështu me 21 deri me 25 maj 1912 në Junik mbahet Kuvendi me nismën e Hasan Prishtinës. Aty shtrohen qeshtjet kryesore:

*Bashkimi i Kryengritësve Shqiptarë nënë drejtimin e një komiteti të vërtetë kombëtarë.

*Të ketë një organ shtypjeje në gjuhë të huaj.

*Të propogandoj programin e luftës të

armatosur të popullit shqiptarë.

* "Lirinë administrative të Shqipërisë".

Ky kuvend u përfaqësua nga 250 delegatë shqiptarë. - Hasan Prishtina u përkrah fuqimisht nga Bajram Curri. Përfundimisht në këtë kuvend historik, delegatët ja dhanë besën njëri-tjetrit shqiptarë për të bërë një kryengritje të përgjithshme kundër sundimit Turk.

Në këtë kuvend u aprovua, nga delegatët dhe u shpall programi politik i kryengritjes, i cili iu dërgua qeverisë turke në Stamboll.

Programi kishte kryesisht këto qeshtje:

*Njohja e autonomisë të Shqipërisë.

*Vendosja e administratës Shqiptare.

*Caktimi i gjuhës Shqipe me alfabetin kombëtarë si gjuhë zyrtare.

*Ngritja e flamurit Shqiptarë në të gjithë vëndin.

Emrimi i sternipit të familjeve "Princorë" Shqiptare, si guvernator të përgjithshëm.

Fuqitë e mëdhaja të garantojnë plotësimin e këtyre kërkesave.

Me këtë rast xhonturqit u egërsuan dhe filluan të kundërvihen, duke marrë masa të jashtëzakonshme ushtarake, në drejtim të popullatës shqiptare. Kështu në Ferizaj u sollën tri regjimente turke, në Mitrovicë ishte përqendruar një regjiment i plotë, një bataljon pushkatarësh dhe dy bateri artilerie. Në Prishtinë një regjiment kalorsie dhe një bateri artilerie. Në Prizeren një regjiment kalorsie dhe në Pejë një tjetër regjiment komsorie. Në Gjakovë një regjiment komsorie dhe një regjiment artilerie fushore, një bataljon pushkatarësh. Në Pazar të Ri, në Senicë, në Bërana, në Guci kishte nga dy batal-

jona, ndërsa në Plavë një regjiment dhe një kompani mitrolozash.

Përballë kësaj ushtrie të madhe, ishin forcat kryengritëse shqiptare, që ishin gjysëm të armatosur, por të vendosur deri në vdekje për të luftuar për çlirim dhe vëndit.

..... Luftimet vazhdonin. -Më e theksuar ishin luftimet e 6 qershorit 1912, ku forcat e armatosura shqiptare, në bashkëpunim me Malsinë e Gjakovës shpartalluan kazarmat armike në Guci dhe në Bëran, dhe pastaj vijuan rrugën për në Krasniqe, ku u bashkuan me forcat e tjera shqiptare. Po me 9 dhe 10 qershor 1912 kryengritësit shqiptarë, të cilët ishin rreth 2000 vetë, u armatosën me armët e municionet të marra në kazermat ushtarake turke të Gucisë.

Gjatë këtyre luftave turqit lanë 300 të vrarë, të plagosur dhe rob lufte, kryesisht në Has, Gashë, Bytyç dhe në Qafën e Prushit.

Këto luftime të kryengritësve shqiptarë i dhanë një shtytje të fuqishme lëvizjes së armatosur shqiptare edhe në viset e tjera shqiptare.

Këto fitore bënë të aktivizoheshin edhe lvizjet e tjera shqiptare, në fiset verilindore dhe lindore të Shqipërisë.

Me 17 korrik 1912 kryengritësit shqiptarë hynë në Gjakovë dhe pastaj ju drejtuan Prishtinës.

Paria shqiptare pati përfaqësues në Prishtinë nga Gjilani, Presheva, Vuçiterna, Mitrovica, Pazari i Ri, Prizereni, Peja, Gjakova dhe Rozhaja.

..... Përfundimisht Akti i 28 Nëntorit 1912, sanksionoi drejtë e pa mohueshëm historike e kombit shqiptarë për të qënë të bashkuarë, të lire e të pamvarur në trojet e veta, krahas popujve të tjerë të Gadishullit Ballkanik.

Kjo kumtesë u mbajt në Plavë gjatë sessionit shkencor dy ditorë me pjesëmarrjen e Kosovës, Shqipërisë, komunitetët shqiptarë Malit Zi, SHBA, Gjermani, Zvicër dhe Belgjikë.

KUVENDI I FANIT 1911 (vijon)

Kur bashkoheshin burrat n'betaja
Aty anmikut i hynte t' merra
Prej ardhje ilir, emnin shqiptar
Me ideal te pastër shumë fetarë
Shqiptarise jetën ia kanë falë.
Jetë e rande iu impunue
500 vjet tuj t'sundue
Veshtirësi mbi veshtirësi
500 vjet moti tu n' zi
500 vjet ne errësinë
500 vjet sundim pa mëshirë
500 vjet dhunue lirinë.

Sundim t'ranë përballove
Besnik shqiptarise i qendrove
Me guxim i kundërshtove.
Me respekt shkruen historia
Shqiptari e fe si l' shoj malcia.
Pesë shekuj luftë heroike
U organizuan mbi 50 kryengritje
Dhe 20 kuvende historike,
Me fryme nacionale, atdhetare
Urrejtja e guximi zemrat i mbushi
Nevojën për luftë në shpirt e futi.

Ideja e luftës flamurin skuq
Smajl Qemalit e Luigj Gurakuqi.
Idetë hynë në zemrat tona
Dhe jashtë vëndit iu ndie jehona
U ndergjegjesuan malcitë tona.
Kur qendresë banë bijtë e shqiptarise
T'merr muer Porta e Stambolit.
Dy detyra në plan të parë
N'luftë me dalë shqiptarët mbarë
Luftetar dhe atdhetarë.

Me forcë pushtuesin me largue
I ka ikë koha me sundue.
Fati kohës i ka ardhë
Kuj i rrahë zemra shqiptarë
Sot a kurrë në luftë me dalë.
Kur zemrimi e humbi durimin
Kapën armët dhe filluen luftimin.
Filluen kryengritje në tërësi
N'malësitë Mbishkodrës dhe n'Mal të Zi
Grupe të fshehta në Greçe e Itali.

Maqedoni e Prishtinë
Muarën lëvizjet epërsi.
Patriotet n'qytete punën nisën
Me ndihmue kudo levizjen
Me program e ide nacionale
U ba kryengritja e Malsisë Madhe
E Kuvendi i burrave të Greçës
Po i shërbejnë shumë qendresës.
Mori jeta shumë gjallëri
Një kuvend që pat rendësi.

Në Fan të Mirditës banë qeveri
U mblodhen krerët e malësisë
Ashtë kuvendi i historisë
Ishte koha që nuk pret
Në prill të vitit 1911
Ashtë kuvendi i ditëve të fatit
Janë paritë e Shkodrës, Dibrës e Matit
Dukagjinit dhe fisit të Hasit
Të Oroshit e të Spaçit.
Me i përmendë burrat e ndërë
Sadri Luka ashtë prej Thethit.

Dy kreshnikë rritë në shalë,
Kolë Mark Kola trim i rrallë
Marash Nika flamurtarë.

Ardhë prej Shoshit dy sokola,
Grimc Ndou dhe Gjelosh Kola.
Një burrë trim thue rrin me zana,
Qerim Nduen ka çue Toplana.
Dy burra t'zgjedhur çue Mërturi,
Gjon Difi e Prel Tuli.
Një burrë tjetër që e njofti moti,
Ashtë prej Nikajsh Mark Sokoli.

Prej Berishe ai Prend Uka,
Ba të njoftun tersve e pushka.
Ai Frok Kola i fisit t'Thaçit,
E Zef Ndoi i flamurit t'Spaçit.
Aty burrat e vatanit,
Ndue Përdoda prej Gojanit.
Prej Kthellës Dodë Bardhoku,
Preng Mark Prenga prej Oroshit.
Ardhë prej Shkodre një sokol burrit,
Ashtë Gega i Filip Çunit.

Ndue Ndrec Lazri në Korthpule të Dibrit
Marë po i jep burri mendimit.
Një burrë nderi rrin në krye t'parisë
Torenc Toçi arbëresh i Italisë,
Don me i falë jetën Shqipërisë.
Atë një burrë e shoqëroi
Ashtë prej Shkodrë mirë po folë
Zef Shentoja trim me shkollë.
Torenc Toçin e prezentoj,
Gjithë veriun ai e përshkoi,
Strategjinë ia studioj.

Prej n'Mal të Zi shkoi në Kelmend,
I pëlqej shumë ai vend.
Dukagjinit e shkeli në kambë,
Kaloi Drinin në Toplanë,
Malësitë e Pukës m'rrini në Fan
Rendësi Kuvendit i ka dhanë.

Kuvend lufte si dikur motit,
Si në kohën e Gjergj Kastriotit.
Si këta burra e shqiptarë të tjerë,
Njoftë për pushkë e besë e nderë,
I kanë dhanë shqiptarise vlerë.

U bashkuen me përkushtim,
Gjithë shqiptarët pa dallim
Detyrë dite për luftim.
Në Kimëz të Fanit banë pleqni
Me ba lufte me Turqi,
Për me shpallë një Pavarësi
E krijuan një qeveri
Qeveri lufte provizore
Me çue shqiptarinë në fitore
Me kryetar një burrë zakonit
Marka Prenga prej Oroshit.

Në Kuvend me rendësi,
U ngit flamuri kuq e zi,
Me qendruë në përjetësi.
Atë flamur shumë të dëshruem,
Që kaq vite e kërkua.
Ranë në gjunje përpara tij,
Para tij ata u betuen,
Me lot në sy fort e shtërnguan,
Rreth tij ata u bashkuan.

Gjithçka u tha e u mendue,
Ashtë u vendos dhe u veprue
25 burra e kanë nënshkrue.
Sa t'vazhdojnë shekujt e jeta,
Shqiptaria i ruan vlerat e veta.
Të gjithë shekujt që do t'vinë,
Do t'ja ruejnë Shqipërisë lavdinë,
Në përjetësim Pavarësinë.

Nga Pjetër Gera – Belgjike

UJERAT TERMALE "LLIXHAT" NDIKOJNE NE RIGJENERIMIN E INDEVE DHE SHERIMIN E SHUME SEMUNDJEVE

Nga IONE DEDA

Vendi ynë, ka pasuri nëntokësore te pakrahasueshme me asnjë vend tjetër te botes. Ujerat termale te pasura me kripëra qe burojnë ne disa vende te Shqipërisë: Ne Ilixha te Dibrës, ne Elbasan, ne Laç e te tjera, kane dhënë rezultate shume te larta ne shërimin e qindra te sëmundjeve.

Ujerat termale te Dibrës shërojnë:

Sëmundjet e aparatit lokomotor:

*Sëmundjet reumatike inflamatore (subakute dhe kronike)

*Poliartriti reumatik kronik

*Spondiliti ankilozat

*Artriti reumatik

*Artritit e tjera seronegative

*Osteoartritit

*Spondiloartrozat

*Periartritit

*Tendinitit

*Entesitit

*Synd. I tunelit karpal

*Atrofitë muskulore

*Mialgjiite

*Schleronia

Sëmundjet e sistemit nervor :

Dëmtimet e sistemit nervor periferik

Paralizat kompresive që prekin një

nerv se një pleksus

Synd. e pleksit brakial

Raikulopatia lumbosakrale

Paraliza e n. facial

Polyradikuloneuritit

Rehabilitimi I deicittit neurologjik pas

aksidenteve cerebro-vaskular

Sëmundjet demilinizuese (Scleroza Multiplex)

Sëmundja e parkinsonit

Paraliza Cerebrale

Ataxia spinocerebellare

(M.Friedereich)

Sëmundjet e sistemit Gastro-Intestinal:

Gastriti atrofik kronik

Ulcera Gastro-Duoemale peptike

Regurgitimi Gastro-Ezofageal

Konstipacioni kronik

Kalkulozat biliara

Inflamacionet e fshikees biliare

Sëmundja inflamatore e Kolonit (Coliti ulcerativ, M.Crohn)

Sëmundjet e sistemit respirator:

Bronkiti kronik

Astma Broniale

Sinusitet

Rinitit

Frangtet

Laringitet

Sëmundjet e sistemit Uro-Gjenital:

Inflamacionet kronike të veshkëve, vezikës dhe rrugëve urinare

Nefrolitiazat

Proçeset inflamatore të organeve gjenitale:

Vaginitit

Cervicitit

Endometritit

Sëmundjet inflaatore Pelvike

Insuficienca ovariale dhe uterusit

Steriliteti femëror (primar dhe sekundar)

Sëmundjet endocrine:

Obesiteti

Hyperuricemia

Sëmundjet ortopedike dhe gjendjet post-traumatike

Rehabilitimi pas polytraumave

Rehabilitimi i frakturave, luksacioneve dhe sublüksacioneve

Rehabilitimi i kontrakturave post traumatike

Diskopatite pre dhe post operative

Sëmundjet e Lëkurës

Eczemat

Psoriazat

Infeksionet e lëkurës:

Dermatophitosat

Candidiasa

Tinea

Versikolor

Herpes Simplex

Herpes Zoster

Acent

Sëmundjet e Lëkurës

Edhe pse në kohën e sotme janë bërë

arritje shumë të mëdha në trajtimin e sëmundjeve të lëkurës, prapëseprapë balneoterapia mbetet një nga opsionet më të mira dhe më të sigurta në këtë fushë.

Këtu duhet cekur se pak ujera termonineral nëpër botë plotësojnë vetitë kimike në trajtimin e kësaj sëmundjeje pasi vetëm banjat (Ilixhat) me përmbajtje të lartë sulfuri dhe ujë hipotonik në shërimin e sëmundjeve të lëkurës.

Në këtë kontekst Banjat e Dibres-Capa disponojnë me ujera termominerale që ndihmojnë në mënyrë të përkryer në shërimin e shume sëmundjeve te lëkurës si:

* psoriazes,

* ekzemes,

* dermatomykozave

* herpesit e te tjera.



Sukses i veçantë është arritur sa i përket sëmundjes të Psoriazës. Psoriaza është sëmundje kronike, jo ngjitëse, inflamatore e lëkurës që karakterizohet nga zona të skuqura të mbuluara nga luspa me ngjyrë të bardhë. Një deri ne tre për qind e popujve mbarë botës janë të prekur nga psoriaza me një shpejtësi më të madhe në Evropë dhe Amerikën e Veriut. Prek me shume moshat nga 15-45 vjet.

Uji hipotonik dhe me përmbajtje të lartë të sulfurit e ben këtë qendër ndër më të dalluarat jo vetem në rajon por edhe më gjerë. Studimet shkencore tregojnë për veprim të lartë anti-inflamator të këtyre ujërave sulfuror në sëmundjen e psoriazes. Pacientet që janë trajtuar në Banjat e Dibrës për sëmundjen e psoriazes kane pasur përmirësim të konsiderueshëm dhe të qëndrueshëm të simptomave. Vlen të theksohet se kemi vërejtur uljen e jashtëzakonshme të sipërfaqes të lëkurës e prekur nga psoriaza dhe zvogëlim të aktivitetit të saj.

Këto dy parametra të përmendura më lartë përbejnë treguesin më të rëndësishëm që përdoret në të gjithë botën lidhur me sëmundjen e psoriazës. Në ekzaminimet histologjike pas mbarimit te balneoterapisë është vënë re ulje e qelizave imunitare dhe disa substancave toksike që janë edhe baza në zhvillimin e psoriazës.

Sëmundjet e sistemit nervor

Ujërat minerale të Banjave të Dibrës janë hypertermale, radioaktive, te pasura me oligoelemente dhe kjo përberje e ujërave me vetitë fizike (termike dhe mekanike) dhe kimike bën që të kënd efekt shërues ne sëmundjet të ndryshme, gati në të gjithë sistemet e organizmit.



REDAKSIA
 Kryeredaktor: Lazër Kodra
 Redaktorë: Drita Shyti, Roza Pjetri,
 Prelë Milani, Luigj Shyti, Suela Ndoja,
 Zef Nika,
 Florenc Buxha, Lulash Brigja